



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 50 regjistër (JR)  
Datë 18.11.2020

Nr. 49 i vendimit  
Datë 20.12.2022

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 20.12.2022, në orën 14:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 50/2020, datë 18.11.2020, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Darjel Sina.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 257, datë 12.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, Neni C, pika 2, Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoji Komisioneren Publike Irena Nino, e cila përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 257, datë 12.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, që kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi çështjen në tërësi,

### **VËREN:**

#### **I. Në lidhje me rrethanat e çështjes**

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtares pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Fillimisht, në funksion dhe për zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1; 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht: deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “IKLD”), sipas të cilave ka rezultuar:

**2.1** ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport<sup>1</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

1. *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.*
2. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
3. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
4. *Nuk ka kryer deklaram të rremë.*
5. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

---

<sup>1</sup> Raporti i ILDKPKI-së nr. {\*\*\*} prot., datë 05.06.2018.

2.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin<sup>2</sup> për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 17.02.2020 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit (në vijim “KDZh”) nr. {\*\*\*}, datë 06.02.2020), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit. Komisioni ka kërkuar përditësimin e raportit nga DSIK-ja bazuar në informacionet e marra nga organet ligjzbatuese, si dhe rishikimin e raportit në rast evidentimi të elementeve që do të bënin të domosdoshëm ndryshimin e raportit të mëparshëm. DSIK-ja, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.03.2020, vuri në dispozicion raportin e rishikuar nr. {\*\*\*} prot., datë 19.12.2019, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZh-së nr. {\*\*\*}, datë 28.02.2020, në përfundim të të cilit nuk është ndryshuar konstatimi fillestar.

2.3 IKLD-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raportin e hollësishëm e të arsyetuar me nr. {\*\*\*} prot., datë 27.11.2018, për subjektin e rivlerësimit.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe IKLD-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit dhe, bazuar në tri kriteret e rivlerësimit (të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale), mori vendimin objekt shqyrtimi nr. 257, datë 12.06.2020.

## **II. Në lidhje me vendimin e Komisionit**

4. Komisioni, pasi kreu hetimin administrativ dhe dëgjoji subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, në seancë dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura prej saj dhe pasi konstatoi se subjekti ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, me vendimin nr. 257, datë 12.06.2020, vendosi:

4.1. *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.*

4.2. *Transferimin e çështjes civile nr. {\*\*\*} akti, me palë ndërgjyqëse: paditës A. Ç., e paditur Zyra Përmbartimore “{\*\*\*}” ShPK, person i tretë A. (A.) K. të gjykuar në Gjykatën e Apelit*

---

<sup>2</sup> Raporti nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017.

*Gjirokastër me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.05.2015, pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.*

5. Më datë 24.07.2020, Komisioneri Publik Darjel Sina ka ushtruar<sup>3</sup> ankim ndaj vendimit nr. 257, datë 12.06.2020, të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni. Ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor, sipas nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
6. Subjekti i rivlerësimit, më datë 05.08.2020, ka paraqitur pranë Komisionit apel kundërshtues ndaj ankimit nr. {\*\*\*}, datë 24.07.2020, të Komisionerit Publik. Nëpërmjet apelit kundërshtues, subjekti i rivlerësimit pretendon se shkaqet e ankimit të parashtruara nga Komisioneri Publik janë të pabazuara në fakte e në prova dhe, si të tilla, ato nuk mund të sjellin cenimin e vendimit të Komisionit, dhe në përfundim ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit nr. 257, datë 12.06.2020, të Komisionit. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit të parashtruara nëpërmjet apelit kundërshtues do të paraqiten në mënyrë të detajuar sipas shkaqeve të ankimit më poshtë.

### **III. Në lidhje me shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik**

7. Komisioneri Publik Darjel Sina (në vijim “Komisioneri Publik”), duke konsideruar ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë, për këtë arsye ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 257, datë 12.06.2020, për subjektin e rivlerësimit, duke kërkuar kontrollin e këtij vendimi nga Kolegji. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, të cilat lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe aftësive profesionale, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

#### *Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë*

7.1 Lidhur me të dhënat e rezultuara nga korrespondenca me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (në vijim “DPPPP”), si dhe me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (në vijim “OShEE”), Komisioneri Publik pretendoi se në gjendjen që ndodhen këto akte, paraqesin nevojën për riçeljen e hetimit gjyqësor, pasi hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk ka qenë i gjithanshëm, i plotë dhe shterues. Këto rrethana duhen hetuar me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve që kanë lidhje me rrethanat e çështjes, në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë apo të vlerësimit të përgjithshëm të tri kriterëve, sipas përcaktimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 4 të ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik parashtrroi në ankim se vlerësimi i këtyre rrethanave merr rëndësi në rastin konkret, pasi eventualisht ato do të ndikonin në vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë dhe shpenzimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

---

<sup>3</sup> Ankimi është protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*}, datë 24.07.2020.

7.2 Lidhur me pasurinë “Apartament banimi me sip. 123,5 m<sup>2</sup> dhe garazh me sip. 26,9 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë”, Komisioneri Publik, në lidhje me burimin e deklaruar si kursime familjare ndër vite, pretendoi se rezultatet e analizës financiare të Komisionit mbi burimet e ligjshme për shlyerjen e pagesës së pasurive, nuk mbështeten në gjendjen faktike të akteve në dosje dhe me arsyetimin ligjor të bërë prej tij. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, nuk provoi se personi tjetër i lidhur, nëna e saj, mbulon me burime të ligjshme shumën e dhënë në formë ndihme/huaje, në vlerën 3.780 euro, ndaj nuk duhet të konsiderohet si burim i ligjshëm i pagesës së blerjes së pasurive “apartament dhe garazh”. Gjithashtu, huaja e dhënë nga nëna e subjektit të rivlerësimit dhe shuma 102.000 lekë të ardhura nga qiraja janar-qershor 2008, për të cilat detyrimet tatimore janë paguar gjatë procesit të rivlerësimit, nuk duhej të ishin përfshirë si të ardhura të ligjshme në vlerësimin e burimit të krijimit të pasurive, duke rezultuar në pamjaftueshmëri në këtë masë. Në përfundim, Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke mos mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet e deklaruar për vitet 2008 – 2016, gjë që do ndikonte në vlerësimin përfundimtar për subjektin e rivlerësimit, në këndvështrim të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

#### *Lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale*

7.3 Komisioneri Publik pretendoi në ankim se lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, për subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, kanë rezultuar disa mangësi. Referuar burimeve të vlerësimit sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”) i ndryshuar, raport-vlerësimit të IKLD-së, si dhe hetimit administrativ të Komisionit, problematikat dhe mangësitë e gjetura konsistojnë, referuar të dhënave për 4 dosje (nga pesë dosjet e shortuara), objekt vlerësimi sipas nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në faktin se vendimet e ndërmjetme arsyetohen në nivelin minimal dhe në përgjithësi atyre iu mungon referenca ligjore, vendimet gjyqësore janë arsyetuar jashtë afatit ligjor, subjekti nuk disponon me vendim/urdhër formal për caktimin e seancës dhe nuk kujdeset që aktet e njoftimit të përfshihen rregullisht në dosje. Në dy prej këtyre dosjeve, subjekti nuk disponon me vendime të ndërmjetme. Në pjesën hyrëse të vendimit, mungon data e regjistrimit të çështjes në gjykatë, gjeneralitetet e plota të palëve apo aktet e përfaqësimit të tyre.

7.4 Lidhur me tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioneri Publik pretendon se çështja civile, me palë A. Z. dhe K. K., regjistruar më datë 08.04.2013 dhe përfunduar më datë 29.04.2014, pas marrjes së çështjes nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e relatores, gjykimi i çështjes ka zgjatur 9 muaj e 20 ditë, pra në tejkallim të afatit 6-mujor të gjykimit civil, të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”) me nr. 261/2, datë 14.04.2010, “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”. Çështja penale me të pandehurin A. N., regjistruar më datë 12.03.2014 dhe përfunduar më datë 19.02.2015, ka zgjatur 11 muaj e 7 ditë, edhe kjo në tejkallim të afatit 6-mujor të parashikuar në vendimin e KLD-së më sipër, për gjykimet penale në Gjykatën e Apelit. Në përfundim, Komisioneri Publik, mbështetur në standardet e përcaktuara në

nenin 74 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, vlerëson se është përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit që për secilin rast të trajtuar, duhet të kishte marrë masa për të shmangur shkeljen e afateve të gjyqimit të çështjes, të arsyetonte vendimet e ndërmjetme me bazën ligjore përkatëse, të kujdesej për aktet dhe efektivitetin e njoftimit të palëve, arsyetimit në kohë të vendimeve dhe dorëzimit të dosjeve, verifikimit të plotësisë dhe korrektësisë së dosjeve gjyqësore, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të procesit gjyqësor.

7.5 Komisioneri Publik pretendoi se, duke i marrë së bashku këto gjetje, përfshirë dhe çështjen civile nr. akti {\*\*\*}, të vitit 2015, të transferuar nga Komisioni pranë organit kompetent për inspektim, sipas nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, mund të çojnë në një vlerësim të ndryshëm nga sa ka arritur Komisioni.

7.6 Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, neneve 4, 30-34, 40-44, pikave 3, 4 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik kërkoi që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues të vendosë në mënyrë alternative:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 257, datë 12.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; ose:*
- *Lënien në fuqi të këtij vendimi.*

#### **IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

##### *A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit*

###### *i. Juridiksioni i Kolegjit*

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### *ii. Legjitimimi i ankuesit*

9. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

10. Në përputhje me nenin 65<sup>4</sup>, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë gjyqësore publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 257, datë 10.06.2020, për subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të Komisionerit Publik dhe të subjektit të rivlerësimit.

*B. Hetimi gjyqësor në Kolegj*

11. Në seancën gjyqësore publike të datës 13.12.2022, Komisioneri Publik, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, argumentoi se, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, rezulton se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke mos mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe investimet e deklaruara për vitet 2008 - 2016. Kjo pamjaftueshmëri, në varësi edhe të rezultateve të hetimit të kërkuara në ankim, do të ndikonte në vlerësimin përfundimtar për subjektin e rivlerësimit, edhe në këndvështrim të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016. Sa i përket vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioneri Publik vlerësoi se mbështetur në standardet e përcaktuara në nenin 74 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, është përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit që, për secilin rast të trajtuar, duhet të kishte marrë masa për të shmangur shkeljen e afateve të gjykimit të çështjes, të arsyetonte vendimet e ndërmjetme me bazën ligjore përkatëse, të kujdesej për aktet dhe efektivitetin e njoftimit të palëve, arsyetimit në kohë të vendimeve dhe dorëzimit të dosjeve, verifikimit të plotësisë dhe korrektësisë së dosjeve gjyqësore, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të procesit gjyqësor. Mangësitë e vërejtura paraqiten të natyrës përsëritëse dhe, si të tilla, të vlerësuara së bashku me mangësitë e konstatuara në çështjen e transferuar nga Komisioni pranë organit kompetent për inspektim, sipas nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, mund të çojnë në një vlerësim të ndryshëm nga sa ka arritur Komisioni.
12. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj në seancën e datës 13.12.2022, kërkoi që qëndrimi i Komisionit, sipas të cilit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, është i mbështetur në një vlerësim të drejtë të fakteve që kanë rezultuar nga hetimi dhe në legjislacionin e zbatueshëm. Subjekti i rivlerësimit kërkoi të administrohen provat që paraqiti gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, dhe pretendoi se vendimi i Komisionit është i drejtë e i bazuar në ligj, ndaj për këtë arsye, kërkoi nga Kolegji lënien në fuqi të këtij vendimi.

---

<sup>4</sup> *Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.*

13. Kolegji çeli hetimin gjyqësor për të mundësuar hetimin e fakteve të pretenduara në ankim dhe në apelin kundërshtues. Për pasojë, në kuadër të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 45 dhe 49/1 të ligjit nr. 84/2016, mori në cilësinë e provës aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancën e datës 13.12.2022, për sa ato lidheshin me shkaqet e ankimit dhe nevojën e subjektit të rivlerësimit për t'i prapësuar, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Kolegji lejoi nënshtrimin e tyre debatit gjyqësor e më pas i vlerësoi ato në raport me vendimin objekt shqyrtimi dhe shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik.
14. Kolegji vlerësoi të gjitha shkaqet e ankimit në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, të përbërë nga aktet e përcjella në Kolegj nga Komisioni dhe aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore publike, datë 13.12.2022, të zhvilluar në Kolegj. Bazuar në situatën faktike të konstatuar dhe legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionet e mëposhtme.

*C. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit*

15. Komisioneri Publik, bazuar në aktet e administruara në dosjen e Komisionit dhe rrethanat e çështjes, pretendon se në gjendjen që ndodhen aktet, paraqesin nevojën për riçeljen e hetimit gjyqësor, pasi hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk ka qenë i gjithanshëm, i plotë dhe shterues. Komisioneri Publik ka konstatuar se nga korrespondenca<sup>5</sup> me OShEE-në, kjo e fundit ka konfirmuar disa kontrata furnizimi të energjisë elektrike në emër të personave të lidhur të subjektit të rivlerësimit, për të cilat nuk rezulton që Komisioni të ketë hetuar apo vlerësuar më tej për këto të dhëna. Gjithashtu, nuk rezulton të jetë hetuar apo mbajtur korrespondencë me shërbimet e Ujësjellës Kanalizime Tiranë, për të verifikuar ekzistencën e kontratave të lidhura nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioneri Publik konstatoi se nga korrespondenca e Komisionit me DPPPP-në, kjo e fundit ka konfirmuar<sup>6</sup> se personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A. A., del si palë nënshkruese në disa kontrata kredie, ku sipas informacionit të dokumentuar, për kontratën e datës 21.06.2012, me vlerë 2.400.000 lekë, burimi i fondeve përshkruhet si “të ardhura familjare”. Ky informacion nuk përputhet me informacionin<sup>7</sup> e DPPPP-së, dërguar ILDKPKI-së, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioneri Publik pretendoi se këto indicie nuk janë hetuar nga Komisioni, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve që kanë lidhje me rrethanat e çështjes, në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë apo të vlerësimit të përgjithshëm të tri kriterëve, sipas përcaktimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 4 të ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik parashtrroi se vlerësimi i këtyre rrethanave merr rëndësi në rastin konkret, pasi eventualisht ato do të ndikonin në vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë dhe shpenzimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

<sup>5</sup> Me shkresën e OShEE-së nr. {\*\*\*} prot., datë 29.10.2019.

<sup>6</sup> Me shkresën e DPPPP-së nr. {\*\*\*} prot., datë 25.10.2019.

<sup>7</sup> Me shkresën e DPPPP-së nr. {\*\*\*}, datë 10.05.2017.



**15.1** Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, në apelin kundërshtues të paraqitur prej saj, lidhur me këtë shkak ankimi të Komisionerit Publik, parashtroi se Komisioni me të drejtë është bazuar në aktet e administruara dhe rrethanat e çështjes, të cilat në gjendjen që janë, nuk paraqesin nevojën për riçeljen e hetimit gjyqësor, pasi hetimi administrativ i kryer nga Komisioni ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm. Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, pretendon se rihetimi nuk do të ndikonte në ndryshimin e konkluzioneve për vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë së subjektit dhe të personave të lidhur, por shprehu gatishmërinë, që në rast se Kolegji vendos riçeljen e hetimit gjyqësor, të përgjigjej për çdo paqartësi që ekziston në procesin e saj të rivlerësimit.

**15.2** Nga dokumentacioni që është administruar në dosjen e Komisionit, lidhur me shkakun e ankimit të ngritur nga Komisioneri Publik për nevojën e hetimit të mëtejshëm për pasurinë e subjektit të rivlerësimit, nga trupi gjykues i Kolegjit u mor në analizë shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 29.10.2019, e OShEE-së, nga e cila rezultojnë të dhënat si më poshtë.

- i. Për gjeneralitetet **A. Y. A.**, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një kontratë e furnizimit me energji elektrike me nr. {\*\*\*}, në instancën Gjirokastër.
- ii. Për gjeneralitetet **A. A.**, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohen 2 kontrata furnizimi, një në Gjirokastër me kontratën e furnizimit nr. {\*\*\*} dhe një në Tiranë me kontratën e furnizimit nr. {\*\*\*}.
- iii. Për gjeneralitetet **E. A.**, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohen 8 abonentë me kontratë të furnizimit me energji elektrike me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
- iv. Për gjeneralitetet **Y. A.**, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohen dy abonentë me kontratë të furnizimit me energji elektrike me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në instancën Vlorë.
- v. Për gjeneralitetet **T. S.**, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një abonent me kontratën e furnizimit nr. {\*\*\*}, në instancën Gjirokastër.

Në këtë shkresë citohet se: *Sipas të dhënave në Sistemin e Faturimit që përfaqëson bazën e të dhënave të shoqërisë sonë, rezulton se konsumatorët janë të regjistruar vetëm me emër, mbiemër dhe jo me atësi. Në bazë të kushteve rregullatore të mëparshme, konsumatorët nuk ishin të detyruar të paraqisnin të dhëna të detajuara personale apo një kopje të dokumentit zyrtar të identifikimit. [...] lutemi që këto të dhëna të merren në konsideratë me rezervë sepse për shkak të mungesës së pasqyrimin të të dhënave më të detajuara, nuk sigurojmë saktësinë e plotë të tyre.*

Kësaj shkrese i janë bashkëngjitur printime nga sistemi elektronik i OShEE-së, mbi kërkimin e informacionit në këtë sistem dhe rezultatet e gjeneruara prej tij.

**15.3** Në lidhje me korrespondencën e OShEE-së, subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, në apelin kundërshtues të paraqitur prej saj, ka sqaruar se janë konfirmuar disa kontrata furnizimi të energjisë elektrike në emër të personave të lidhur, për të cilat ka parashtruar si në vijim.

**15.3.1** Për kontratën e shënuar në pikën **(i)** më sipër, për personin e lidhur A. A., subjekti sqaroi si në apelin kundërshtues, ashtu edhe në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, se i përket pasurisë së fituar me ligjin nr. 7652 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të deklaruar në deklaratën periodike dhe atë *vetting*. Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, saktësisht printimet nga sistemi i OShEE-së, të cilat i janë bashkëngjitur shkresës së kësaj të fundit, të dhënat e abonentit figurojnë me atësi (A. Y. A.), si dhe me specifikime të tjera teknike, të cilat krijojnë bindjen e trupit gjykues se kemi të bëjmë me të njëjtën pasuri që pretendon subjekti i rivlerësimit.

**15.3.2** Për kontratat e shënuara në pikën **(ii)** më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendon se i përkasin përkatësisht pasurisë së luajtshme “{\*\*\*}”, ndodhur në Përmet, në emër të bashkëshortit, pajisjet e së cilës pas çmontimit vullnetar, janë shitur nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe janë deklaruar si në deklaratën periodike të vitit 2014, ashtu edhe në deklaratën *vetting*. Ndërsa për kontratën e rezultuar në Tiranë, subjekti pretendon në apelin kundërshtues se i përket pasurisë së saj në bashkëpronësi me bashkëshortin, të cilën e ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2008 dhe në atë *vetting*. Në informacionin e sistemit të OShEE-së që i përket kontratës së furnizimit me energji elektrike në Përmet, për të cilën subjekti pretendon se është ish-pasuria e luajtshme “{\*\*\*}” (kioskë), Kolegji vëren se identifikohet kategoria e abonentit, e cila është shënuar “privat” dhe jo familjar si në dy rastet e kontratave të tjera në emër të A. A., e cila si për aktivitetin, ashtu dhe për adresën e shënuar në kontratë, e bën të besueshëm faktin që kjo kontratë i përket pikërisht objektit “{\*\*\*}” të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, i cili është deklaruar rregullisht si në deklaratën periodike, ashtu edhe në deklaratën *vetting*. Ndërsa për kontratën që i përket apartamentit në qytetin e Tiranës, në informacionin e sistemit të OShEE-së, vërehet se është shënuar kategoria “familjar” dhe adresa “pranë kopshtit zoologjik”, nënstacioni {\*\*\*}. Këto të dhëna të detajuara në kontratë, krijojnë bindjen e trupit gjykues se pasuria për të cilën është lidhur kontrata e energjisë elektrike, i përket apartamentit me sip. 123 m<sup>2</sup> në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me bashkëshortin e saj, në kontratën<sup>8</sup> e shitjes së të cilit është shënuar adresa {\*\*\*}, Tiranë dhe datë instalimi të matësit më 31.12.2008, pak muaj pas blerjes<sup>9</sup> së këtij apartamenti.

**15.3.3** Kolegji vëren se lidhur me të dhënat në pikën **(iii)** më sipër, për personin e lidhur E. A., vajza e subjektit të rivlerësimit, në shkresën e OShEE-së është dhënë informacion se në këtë emër figurojnë tetë abonentë me kontratë të furnizimit me energji elektrike. Bashkëngjitur kësaj shkrese gjenden printimet nga sistemi elektronik i OShEE-së, sipas të cilave rezulton se nuk gjendet asnjë e dhënë për këtë person, pavarësisht se është referuar se figurojnë tetë abonentë. Si rrjedhojë e këtyre rrethanave, informacioni i cituar nëpërmjet shkresës së OShEE-së për këtë abonent (vajza e subjektit të rivlerësimit), nuk përputhet me informacionin që përmban sistemi elektronik i bazës së të dhënave, nga i cili OShEE-ja bazon të dhënat që ka dërguar për të vërtetuar detajet që përmban shkresa. Si rrjedhojë e përmbajtjes së këtyre akteve, trupi gjykues nuk konsideroi se E. A. është abonent që disponon tetë kontrata të furnizimit me energji elektrike, pasi ky informacion i dhënë

<sup>8</sup> Kontratë shitblerjeje apartamenti me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 18.06.2008.

<sup>9</sup> Apartamenti është blerë më datë 18.06.2008.

në shkresën e OShEE-së nuk përputhet me printimet e ekstraktuara nga sistemi elektronik që ka bashkëlidhur ky institucion, nga i cili e merr dhe vetë informacionin.

**15.3.4** Lidhur me kontratën me nr. {\*\*\*}, e shënuar në pikën (iv) më sipër, e cila sipas informacionit të OShEE-së, i përket një abonenti familjar që figuron në Himarë, në emër të Y. A., subjekti pretendon se nuk ka lidhje me djalin e saj Y. A. A.. Subjekti i ka bashkëngjitur apelit kundërshtues vërtetimin me nr. {\*\*\*}, datë 03.08.2020, të lëshuar nga Bashkia Himarë, të cilin e ka paraqitur edhe bashkëngjitur parashtrimeve të dorëzuara<sup>10</sup> në Kolegj. Trupi gjykues vëren se sipas këtij dokumenti, I. A., i biri i K. dhe Sh., i datëlindjes {\*\*\*}, me nr. personal {\*\*\*} është i njëjti person me Y. A. (i cituar në shkresën e OShEE-së), pasi me vendimin nr. {\*\*\*} të Këshillit Bashkiak, Qyteti Himarë, ka ndryshuar emrin nga Y. në I.. Sipas këtij vërtetimi, në bazë të regjistrit themeltar të fshatit {\*\*\*}, është personi i vetëm me këto gjeneralitete, si rrjedhojë trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit provoi se kontrata me numrin e cituar më sipër në këtë paragraf, nuk i përket djalit të saj Y. A., por i përket individit I. A., i cili para vendimit nr. {\*\*\*}, datë 22.10.1991, të Këshillit Bashkiak, Qyteti Himarë, ka gëzuar emrin Y. A., emër të cilin mban kontrata, pasuria për të cilën është lidhur, ndodhet në fshatin {\*\*\*}.

**15.3.5** Për kontratën me nr. {\*\*\*} në emër të T. S. (nënës së subjektit) në Përmet, shënuar në pikën (v) më sipër, subjekti pretendon se ka lidhje me pasurinë në bashkëpronësi, të fituar me ligjin e privatizimit të banesave shtetërore, të deklaruar në deklaratën periodike dhe atë *vetting*. Nga informacioni i OShEE-së, rezulton e cituar kategoria “familjare” dhe adresa Përmet. Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e para fillimit të detyrës të vitit 2003, në rubrikën “pasuri të paluajtshme” ka deklaruar apartament banimi 2+1, me sip. 92,8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie 10/16+1-8, me pjesë takuese 1/5, përfituar nga ligji i privatizimit të banesave. Në dokumentacionin që i përket dosjes së subjektit të rivlerësimit, në dosjen e ILDKPKI-së, gjendet e administruar certifikata për vërtetim pronësie, që i përket pasurisë me nr. {\*\*\*}, e llojit apartament banimi, me sip. 92,8 m<sup>2</sup>, në pronësi të së cilës janë pesë bashkëpronarë, duke përfshirë këtu subjektin e rivlerësimit dhe znj. T. S.. Të dhënat që përmban certifikata për vërtetim pronësie rezultojnë të jenë të njëjta me ato që ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në deklaratën e para fillimit të detyrës në vitin 2003. Në vlerësim të këtyre fakteve, trupi gjykues krijoi bindjen se kontrata e OShEE-së e shënuar në pikën (v) më sipër, i përket nënës së subjektit të rivlerësimit, si kontratë e energjisë elektrike e lidhur për apartamentin e përfituar nga ligji i privatizimit të banesave, në të cilën rezulton bashkëpronare edhe subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni.

**15.3.6** Kolegji vëren se në vlerësim të rrethanave si më sipër, duke u nisur nga dokumentacioni që gjendet i administruar në dosjen e Komisionit, vlerësohet se indicet që i kanë shërbyer Komisionerit Publik për ngritjen e shkakut të ankimit lidhur me kontratat e rezultuara nga sistemi i OShEE-së, janë të pamjaftueshme për të konkluduar se këto pasuri, për të cilat janë lidhur kontrata të energjisë elektrike në emër të personave të lidhur, janë pasuri të cilat nuk i janë nënshtruar procesit të rivlerësimit apo nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

---

<sup>10</sup> Parashtrime dhe akte të protokolluara në Kolegj me nr. {\*\*\*}, datë 12.12.2022.

Për sa është referuar më sipër, trupi gjykues vlerësoi se bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje për këto pasuri, krijon bindjen se janë pikërisht ato, të cilat janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit e që i janë nënshtruar vlerësimit nga Komisioni dhe, në këto kushte, nuk është i nevojshëm qartësimi i këtyre situatave me detaje të tjera apo kryerja e veprimeve të mëtejshme hetimore lidhur me këtë shkak ankimi.

**15.4 Lidhur me të dhënat e informacionit nga DPPPP-ja,** ku bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit A. A. rezulton si nënshkruar i kontratës me vlerë prej 2.400.000 lekësh dhe se burimi i fondeve përshkruhet në informacionin e DPPPP-së si “të ardhura familjare”, Kolegji vëren se në këtë shkresë janë cituar raportime nga bankat, sipas të cilave, transaksionet bankare për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur janë vendosur në formë tabelare, si dhe nga noterët janë raportuar kontratat noteriale për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit.

Lidhur me këto raportime të kontratave noteriale, për burimin e fondeve të njëjës prej të cilave Komisioneri Publik ka ngritur shkakun e ankimit, subjekti i rivlerësimit sqaron në apelin kundërshtues se bashkëshorti i saj, që prej vitit 2005 është në rolin e drejtorit të Degës së Bankës Tirana në qytetin e Përmetit, ndaj ka firmosur një sërë kontratash kredie si përfaqësues i bankës. Sipas subjektit, raportimi i kontratës së vitit 2012 në DPPPP, nuk është i saktë dhe është kryer nga një punonjës, i cili nuk i ka pasur të qarta konceptet sa u takon palëve kontraktuese. Sipas subjektit të rivlerësimit, çdo kredi, të cilën e jep banka, burimi i fondeve janë vetë fondet e bankës dhe jo nga të ardhurat familjare.

**15.4.1** Lidhur me këtë pretendim të Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka bashkëngjitur në parashtrimet e dorëzuara në Kolegji, kontratat<sup>11</sup> e cituara në shkresën e DPPPP-së, ku bashkëshorti i saj ka nënshkruar si përfaqësues i Bankës Tirana, dega Përmet, nga të cilat rezulton si më poshtë.

**15.4.2** Në vlerësim të këtij dokumentacioni (që buron nga informacioni i shkresës së DPPPP-së), Kolegji vëren se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është nënshkruar i këtyre kontratave në cilësinë e drejtuesit të institucionit financiar, dhe në të njëjtat kontrata kanë nënshkruar gjithashtu edhe zv/drejtesja e këtij institucioni, kredimarrësit si përfitues të shumës së marrë hua nga banka, si dhe dorëzanësit në cilësinë e garantorëve për shlyerjen e kredisë.

Konkretisht, kontrata e kredisë me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 21.06.2012, në shkresën e DPPPP-së kthim përgjigje të Komisionit, në informacionin e dhënë për kontratat noteriale, është referuar si kontratë me objekt dhënie kredie për një afat 1-vjeçar, me vlerë 2.400.000 lekë dhe burim të fondeve “të ardhura familjare”. Ky informacion i dhënë nëpërmjet shkresës së DPPPP-

---

<sup>11</sup> Në vërtetimin e njësisë me origjinalin nr. rep {\*\*\*}, datë 08.12.2022, të noterit S. A., me seli në Gjirokastrë, janë bashkëlidhur këto kontrata:

- kontrata me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 05.03.2013;
- shtojcë kontrate me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 31.10.2014;
- kontratë kredie bankare nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 05.11.2014;
- shtojcë kontrate për dhënie kredie bankare me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.03.2015;
- shtojcë kontrate për dhënie kredie bankare nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.06.2012;
- shtojcë kontrate për dhënie kredie bankare nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 01.04.2014;
- kontratë kredie bankare me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 30.10.2014;
- kontratë kredie bankare me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 30.10.2014.

së, përmban edhe 7 (shtatë) kontrata të tjera kredie, nga verifikimi i të cilave rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit figuron nënshkrues i këtyre kontratave për shkak të funksionit të tij si drejtues i Bankës Tirana, dega Përmet. Në këto kontrata të raportuara në informacionin e DPPPP-së, si burim i të ardhurave është deklaruar “veprimtari bankare”, si dhe burimi i fondeve “nga aktiviteti tregtar”. Gjithashtu në shkresën e DPPPP-së janë raportuar edhe kontrata<sup>12</sup> e shitjes së garazhit me sip. 26,9 m<sup>2</sup> dhe me vlerë 10.000 euro, si dhe kontrata e revokimit të shitjes së garazhit, të dyja këto kontrata të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, bashkë me parashtrimet.

**15.4.3** Kolegji vëren se mospërputhja që Komisioneri Publik pretendon se ekziston ndërmjet dy shkresave të DPPPP-së, konsiston në faktin se në shkresën<sup>13</sup> e DPPPP-së, referuar në poshtëshënimin nr. 6 më sipër, dërguar ILDKPKI-së, janë shënuar si raportime edhe dy kontrata<sup>14</sup> të tjera noteriale për blerje apartamentesh, të cilat janë në emër të A. A.. Nga dokumentacioni i dërguar ILDKPKI-së nga znj. F. Z., noterja para së cilës janë lidhur kontratat në fjalë, rezultoi se blerësi A. A. është person tjetër, i lindur në {\*\*\*}, Fier, dhe me datëlindje tjetër nga ajo e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Raportimet e tjera lidhur me kontratat noteriale i përkasin bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Bankës Tirana, dega Përmet, dhe rezultojnë të njëjtat që gjenden edhe në shkresën e DPPPP-së dërguar Komisionit, përmbajtja e së cilës është përshkruar në paragrafin më sipër.

**15.4.4** Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit rezulton si palë nënshkruese në këto kontrata, në kushtet e lëvrimit të fondeve të Bankës Tirana, dega Përmet, nëpërmjet kredihënies në institucionin në të cilin ushtronte detyrën e drejtuesit. Citimi i shprehjes “me burim të fondeve nga të ardhura familjare”, i gjendur në shkresën e DPPPP-së, qartazi i përket një gabimi material në raportimin e transaksionit ose e cituar gabimisht në shkresën e DPPPP-së, ashtu si është gabuar edhe në citimin e datave të dy kontratave<sup>15</sup> noteriale të raportuara në të njëjtën shkresë, nga 30.10.2014 që është data e saktë, në 31.10.2014 që është shënuar gabim në këtë shkresë. Si rrjedhojë e sa më sipër, duke u nisur nga faktet dhe rrethanat që përbëjnë këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se nuk krijohet bindja për ekzistencën e ndonjë dyshimi të arsyeshëm për të hetuar më tej lidhur me burimin e fondeve cituar në raportimin e kontratës së kredisë në shkresën e DPPPP-së ku është raportuar kjo kontratë. Kolegji vlerëson se kjo marrëdhënie juridike, ku bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është i përfshirë në cilësinë e përfaqësuesit të bankës, si drejtues i degës së Bankës Tirana, Përmet, nuk mund t’i nënshtrohet shqyrtimit në Kolegj, pasi do të ishte jashtë objektit të procesit të rivlerësimit

---

<sup>12</sup> Kontrata me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 09.08.2016.

Kontrata me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 08.09.2016.

<sup>13</sup> Kjo shkresë, në fletën e dytë fillon me paragraf të numërtuar 78, por në inventarin e ILDKPKI-së është shënuar numri i fletëve 3 (tre), aq sa disponon Kolegji, ndaj mund të jetë gabim material numërtimi.

<sup>14</sup> Kontrata me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 08.03.2012.

Kontrata me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 08.03.2012.

<sup>15</sup> Kontrata me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 30.10.2014.

Kontrata me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 30.10.2014.

kalimtar. Në përfundim të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues i Kolegjit nuk identifikoi indicie nga ato që ka pretenduar Komisioneri Publik në ankimin e paraqitur prej tij, duke marrë shkas nga raportimet në shkresën e DPPP-së, për të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, sa u përket këtyre kontratave të lidhura në funksion të ushtrimit të detyrës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, si rrjedhojë hetimi i mëtejshëm ishte i panevojshëm.

16. *Lidhur me pasurinë “Apartament banimi me sip. 123,5 m<sup>2</sup> dhe garazh me sip. 26,9 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë”, Komisioneri Publik, në lidhje me burimin e deklaruar si kursime familjare ndër vite, pretendoi se rezultatet e analizës financiare të Komisionit mbi burimet e ligjshme për shlyerjen e pagesës së pasurive, nuk mbështeten në gjendjen faktike të akteve në dosje dhe në arsyetimin ligjor të Komisionit. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi se personi tjetër i lidhur, nëna e saj E. (T.) S., mbulon me burime të ligjshme shumë e dhënë në formë ndihme/huaje, në vlerën 3.780 euro, ndaj nuk duhet të konsiderohet si burim i ligjshëm i pagesës së blerjes së pasurive “apartament dhe garazh”. Komisioneri Publik vlerëson se huaja e dhënë nga nëna e subjektit të rivlerësimit dhe shuma 102.000 lekë të ardhura nga qiraja janar-qershor 2008, për të cilat detyrimet tatimore janë paguar gjatë procesit të rivlerësimit, nuk duhej të ishin përfshirë si të ardhura të ligjshme në vlerësimin e burimit të krijimit të pasurive, duke rezultuar në pamjaftueshmëri në këtë masë. Lidhur me burimin e deklaruar si kredi bankare dhe shlyerjen e saj ndër vite, për mbulimin e shpenzimeve në vitin 2010, Komisionerit Publik i rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe shlyerjet e parakohshme të kredisë në shumën 408.153 lekë për vitin 2011, dhe në shumën 139.631 lekë në vitin 2016. Në përfundim, Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke mos mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet e deklaruara për vitet 2008 - 2016. Kjo pamjaftueshmëri, sipas Komisionerit Publik, në varësi edhe të rezultateve të hetimit që ka kërkuar nëpërmjet këtij ankimi, mund të ndikonte në vlerësimin përfundimtar për subjektin e rivlerësimit, në këndvështrim të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.*

**16.1** *Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: Nga analiza, për periudhën e rivlerësimit 2003 – 2016, subjekti rezulton me një balancë negative prej 537.362 lekësh në vitin 2008, për shkak të mosmarrjes në konsideratë si e ardhur e ligjshme të huas prej 3.780 eurosh, dhënë nga nëna e saj gjatë këtij viti, si dhe një balancë negative prej 208.819 lekësh, në vitin 2010, të cilat në vlerësimin tërësor të çështjes dhe në proporcion me faktet dhe provat e analizuara në këtë vendim, Komisioni nuk i çmoi si shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit.*

**16.2** *Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë blerë një apartament banimi me sip. 123,5 m<sup>2</sup>, në adresën: {\*\*\*}, {\*\*\*}, Tiranë, blerë me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 18.06.2008, në vlerën 105.600 euro, me pjesë takuese 50%, si dhe një garazh me sip. 26,9 m<sup>2</sup> në të njëjtën adresë, me kontratë shitblerjeje nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 18.06.2008, në vlerën 13.000 euro, me pjesë takuese 50%.*

Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e këtyre pasurive, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të tyre. Në faqen nr. 3 të kësaj deklarate periodike, në rubrikën “ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe luajtshme”, subjekti ka deklaruar: *ndihmë monetare nga nëna ime E. (T.) S., për pagesën e këstit të parë të apartamentit, 3.780 euro.* Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit, për këto pasuri ka deklaruar si burim krijimi “Kredi për blerje banese dhe kursimet familjare ndër vite nga pagat familjare (bashkëlidhur kontratë kredie bankare nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 02.07.2008; kontratë hipotekimi nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 02.07.2008; kopje të transfertave bankare të shumës së kursyer gjendje në llogari, si dhe të shumës së përfituar nga kredia në llogarinë e kompanisë ndërtuese/shitëse”.

**16.3** Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se në kontratën e shitblerjes me ekstremitetet e cituara në paragrafin më sipër, është parashikuar se është likuiduar shuma prej 25.600 eurosh jashtë zyrës noteriale, ditën e nënshkrimit të kontratës. Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se në datën 12.06.2008, pra, gjashtë ditë para lidhjes së kontratës, bashkëshorti i subjektit, z. A. A., ka transferuar nga Tirana Bank në llogari të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, shumën prej 38.600<sup>16</sup> eurosh, me përshkrimin: “likuidim pjesor për pasurinë” (kjo shumë përbëhet nga 25.600 euro paguar për apartamentin dhe 13.000 euro paguar për garazhin). Shuma prej 80.000 eurosh, që është pjesa e palikuiduar, do të shlyhej me kredi bankare. Me kontratën e kredisë cituar në paragrafin më sipër, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë marrë nga Banka Tirana, kredi në shumën 80.000 euro, me një afat 15-vjeçar, e cila është përdorur për blerjen e apartamentit 123 m<sup>2</sup> të ndodhur te {\*\*\*}, Tiranë. Mënyra e shlyerjes së kredisë është deklaruar rregullisht në deklaratat periodike 2008-2016, ndërsa në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar detyrim të mbetur, shumën 9632 euro.

**16.4** Kolegji vëren se shuma e dhënë nga nëna e subjektit të rivlerësimit është deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2008 si ndihmë e dhënë nga nëna e saj për blerjen e apartamentit, si dhe kjo shumë është depozituar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, por në deklaratën *vetting* nuk është deklaruar si një nga burimet e krijimit të pasurisë, për këtë arsye Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të saktësojë nëse shuma 3.780 euro është dhuruar apo është dhënë hua nga nëna. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e datës 15.01.2020, ka shpjeguar se shuma prej 3.780 eurosh është dhënë në formë huaje, si ndihmë financiare nga nëna e saj në datën 12.06.2008, pas kërkesës së saj dhe të bashkëshortit, për të bërë të mundur pjesën e parapaguar për blerjen e apartamentit në Tiranë. Sërish Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 3 ka pyetur subjektin e rivlerësimit nëse shuma e dhënë hua nga nëna e saj, është shlyer nga subjekti dhe bashkëshorti i saj e nëse po, në çfarë periudhe është shlyer. Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të këtij pyetësori ka sqaruar se: *Huaja nuk është shlyer ende dhe se është rënë dakord që ajo do të kthehet pas shlyerjes totale të detyrimit bankar. Mosdeklarimi ka qenë një pakujdesi që*

---

<sup>16</sup> Shuma 38.600 euro përbëhet nga maturimi i depozitës së bashku me interesat në shumën 26,890.23 euro, maturimi i depozitës 950.000 lekë, e konvertuar në uuro, derdhje në arkë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në shumën 500 euro dhe shuma prej 3.780 eurosh, dhënë hua nga nëna e subjektit të rivlerësimit.

*ka sjellë si pasojë pasaktësinë e burimit të blerjes, për shkak të ngarkesës gjatë mbledhjes së dokumentacionit për deklaratën “vetting”, por edhe për shkak se gjatë plotësimit të deklaratës, jam mjaftuar me faktin që pagesa e apartamentit është kryer vetëm nga llogaria e bashkëshortit tim, pa u thelluar se në atë shumë ishte përfshirë edhe shuma e marrë nga nëna. Sqaroj se në llogarinë e bashkëshortit tim (përpara se të kryhej transferata te shitësi), ishte kryer kalimi i shumës 3.780 euro nga nëna ime te llogaria e bashkëshortit, duke u bërë në këtë mënyrë, një shumë e vetme, e cila më pas është transferuar në llogarinë e shitësit [...].*

**16.5** Lidhur me shumën 3.780 euro, të dhënë ndihmë nga nëna e subjektit, Komisioni ka vlerësuar se subjekti duket se nuk ka pasur asnjë arsye dhe motiv për të fshehur në deklaratën *vetting* shumën e dhënë nga nëna e saj në vitin 2008, përkundrazi, mungesa e deklarimeve në lidhje me këtë shumë e ka vënë në kushtet e pasaktësisë në deklaram. Komisioni më tej vlerësoi se në përfundim të procesit të rivlerësimit, edhe pse nuk u vërtetuan pasuri të tjera në pronësi të personit të lidhur, znj. E. S., përveç pasurisë së përfituar sipas kontratës së datës 30.08.1993, nga ligji për privatizimin e banesave, pasuri e ndodhur në Përmet, arriti në përfundimin se të ardhurat e dokumentuara nga pensioni për periudhën nga viti 1992 deri më 12.06.2008, në shumën 1.184.085 lekë, nuk ishin të mjaftueshme për t’i dhënë ndihmën financiare vajzës së saj, shumën prej 3.780 eurosh, në vitin 2008, si dhe për të përballuar shpenzimet e saj të jetesës. Për këtë arsye, kjo shumë nuk është përfshirë nga Komisioni në analizën financiare për vitin 2008, vit në të cilin u ble edhe pasuria apartament banimi në Tiranë.

**16.6** Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, në apelin kundërshtues të paraqitur prej saj, për deklaramin e burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën periodike të vitit 2008, ka pretenduar se përshkrimi dhe burimi i pasurisë përbëhen nga dy fletë. Te shtesat dhe pakësimet është pasqyruar shtesa për pasurinë e paluajtshme e llojit apartament banimi dhe garazh, e cila pretendon se ka deklaruar ekstremitetet e kontratës së shitblerjes, kontratë e cila e përmban burimin e krijimit të këtyre pasurive, pagesën paraprake dhe kredimarrjen. Subjekti sqaron se ka shprehur edhe pakësimin e depozitës bankare për parapagimin e këstit të parë të çmimit të apartamentit dhe garazhit sipas kontratës së shitblerjes. Ndërsa kredia, sipas subjektit, është deklaruar si e ardhur dhe si detyrim ndaj bankës në rubrikën përkatëse. Subjekti parashtron se mund të ketë pasaktësi për mënyrën dhe vendin ku është shprehur burimi i krijimit në deklaratën periodike të vitit 2008, pasi shpjegimet janë vendosur në qelizat e deklaratës që subjekti i ka vlerësuar të pasqyrohen, por nga ana tjetër, të gjitha veprimet janë ligjore dhe të kryera nëpërmjet veprimeve bankare, transaksionet e të cilave ndodhen të administruara në dosje.

**16.7** Kolegji vëren se neni D i Aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar se subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë me saktësi, ose plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur, në funksion të vazhdimin të qëndrimit në detyrë, sikurse edhe me detyrimet ligjore të tij si funksionar publik/subjekt i ligjit nr. 9049/2003. Konkretisht, plotësimi me saktësi dhe vërtetësi i deklaratës *vetting* ka rëndësi në zbatimin e duhur të kuadrit ligjor (neni D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të



Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016<sup>17</sup>) dhe nënligjor (udhëzimi nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, i ILDKPKI<sup>18</sup>-së). Këto rregullime kërkojnë që subjektet e rivlerësimit të deklarojnë saktësisht dhe plotësisht pasurinë, të shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të saj, në rastin konkret huan e marrë nga nëna e subjektit si një ndër burimet e krijimit të pasurisë apartament banimi, dhe të mos ketë përpjekje për fshehje apo pasqyrim të pasaktë, si rrjedhojë rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* këtë hua, as si burim i blerjes së apartamentit, por as si detyrim për t'ia shlyer nënës së saj këtë hua, për sa kohë ka shpjeguar në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit se nuk e ka shlyer akoma huan.

**16.8** Nga dokumentacioni i administruar në dosje, konstatohet se deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting*, se kjo pasuri është krijuar me burime nga kredia dhe të ardhurat familjare, nuk është i plotë, pasi në kundërshtim me pikën 7 të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së nuk përfshin burimin e përdorur në momentin e krijimit të pasurisë, huan e deklaruar në DIPP-në e vitit 2008, si të marrë për këtë qëllim nga nëna e subjektit të rivlerësimit, në vlerën prej 3.780 eurosh. Në këto kushte, deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, provohet se nuk është i plotë, parë edhe në raport me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në pyetësorët 2 e 3 të Komisionit, sipas të cilave rezulton se kjo hua nuk është shlyer ende. Trupi gjykues vlerësoi se huaja e dhënë në formë ndihme nga nëna e subjektit të rivlerësimit, në analizën financiare të kryer në Kolegj, të mos konsiderohet në zërin “të ardhura”.

**16.9** Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, subjekti sqaroi në Komision, por edhe në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, se kursimet familjare janë të justifikuara dhe verifikohen lehtësisht për shkak se janë të pasqyruara të gjitha në gjendjet e llogarive bankare. Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, pretendon se me bashkëshortin e saj kanë pasur të ardhura të mira, ndihmuar nga fakti i nivelit të ulët të shpenzimeve për jetesë, si rrjedhojë e vendbanimit në një qytet të vogël, si dhe privimit prej shumë vitesh nga pushimet, udhëtimet dhe festat kanë bërë të mundur kursimet për përmbushjen e detyrimeve. Subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pretendim, ka sqaruar në apelin kundërshtues se për kryerjen e pagesës së kështit të parë të apartamentit në vitin 2008, rezulton me një diferencë pozitive në shumën 72.638 lekë, pa përfshirë në të ardhurat e saj shumën e dhënë hua, 3.780 euro, si ndihmë financiare nga nëna e saj. Komisioni, pasi analizoi dhe mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, në prapësimet e saj ndaj rezultateve të hetimit, si dhe faktet dhe rrethanat, çmoi që të ardhurat nga qiratë për periudhën janar 2008 - qershor 2008, në shumën prej 102.000 lekësh,

---

<sup>17</sup> Neni 33, pika 5, germa “a” e ligjit parashikon: “[...] a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti interesi [...]”.

<sup>18</sup> “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” – pika 17. “Deklarimi i gjendjes “cash” do të njihet si i tillë në konceptin e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, deri në kufirin e shumës 1,5 milionë lekë. Shumat më të mëdha duhet të formalizohen në sistemin bankar, përpara dorëzimit të deklaratës në ILDKPKI, duke bashkëlidhur në çdo rast vërtetimin bankar për këtë veprim”.

detyrimi tatimor i të cilave është paguar më datë 06.03.2020, gjatë procesit të vlerësimit, të merren në konsideratë, fakt i cili sjell si pasojë eliminimin e balancës negative në shumën prej 89.908 lekësh, të rezultuar në Komision për periudhën 01.01.2008 – 31.06.2008.

**16.10** Kolegji vëren se gjatë hetimit administrativ, rezultoi se në DIPP-të e viteve 2003 deri në 2014, përfshi edhe vitet ndërmjet tyre, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga qiraja<sup>19</sup> e objektit “{\*\*\*}”<sup>20</sup>, të ndodhur Përmet. Për vitet 2003, 2004, 2005, 2008 dhe 2012, rezultoi se nuk është paguar tatimi në burim mbi të ardhurat e krijuara nga qiraja. Në lidhje me këto të ardhura, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të vërtetojë me dokumentacion pagimin e detyrimit tatimor për të ardhurat nga qiraja për këto vite. Në dokumentacionin që ka bashkëlidhur në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion edhe pagesën<sup>21</sup> e këtij detyrimi tatimor mbi të ardhurat nga qiraja që i përkasin vitit 2012. Pas njoftimit të subjektit të rivlerësimit për rezultatet e hetimit administrativ, ku Komisioni nuk i ka përllogaritur të ardhurat nga qiratë për vitet 2003, 2004, 2005, 2008, për shkak të mospagesës së detyrimeve tatimore për këtë fitim të realizuar, subjekti i rivlerësimit bashkë me përgjigjet e rezultateve të hetimit ka bashkëngjitur edhe mandatpagesën nga Tirana Bank, të datës 06.03.2020, për pagesën e tatimit mbi qiranë e lokalit për periudhën 2003, 2004, 2008, 2009, në shumën 153.000 lekë. Komisioni i ka përllogaritur këto të ardhura në analizën financiare edhe pse pagesa e këtyre detyrimeve tatimore është kryer gjatë dhe për qëllim të procesit të rivlerësimit. Komisioneri Publik në ankimin e paraqitur prej tij kundërshtoi përfshirjen e këtyre të ardhurave, që i përkasin periudhës janar 2008 deri në qershor 2008 (momentin kur është paguar kësti i parë për blerjen e apartamentit) në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

**16.11** Subjekti i rivlerësimit, lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik për pasaktësi dhe pamjaftueshmëri, ka argumentuar në parashtrimet e dorëzuara në Kolegji, se nuk është i saktë ky qëndrim, meqenëse, referuar analizës ekonomike të kryer në Komision, shuma e diferencave mes të ardhurave, pasurive dhe shpenzimeve për periudhën 2008-2016, del me rezultat pozitiv, në masën 2.044.279 lekë. Sipas subjektit të rivlerësimit, bilanci del pozitiv edhe nëse do të marrim si të mirëqena diferencat e pretenduara nga Komisioneri Publik për vitin 2011 dhe vitin 2016, ku shuma totale e diferencave midis të ardhurave, pasurive dhe shpenzimeve për periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2016, rezulton me një balancë pozitive në shumën 710.477 lekë. Subjekti i rivlerësimit parashtrroi se në të dyja rastet, balanca për periudhën 2008-2016, e pretenduar nga

---

<sup>19</sup>- Kontratë qiraje e datës 29.03.2004, me nr. {\*\*\*} rep., e lidhur mes palëve, qiradhënës A. A. dhe qiramarrës Dh. E.. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e një lokali shërbimi në qytetin e Përmetit, me qira mujore prej 5000 lekësh.

- Deklaratë noteriale me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 17.09.2012, sipas së cilës A. A. dhe Dh. E. deklarojnë, në zbatim të kontratës së qirasë të datës 29.03.2004, se do të përsërisin marrëveshjen e qirasë për një periudhë pa afat dhe me një qira të ndryshuar mujore, në vlerën 20.000 lekë, e cila ka ndryshuar që nga data 01.01.2006 e në vijim.

<sup>20</sup> Ky objekt në material kioske është shitur nga bashkëshorti i subjektit me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 25.08.2014, për çmimin 5000 euro.

<sup>21</sup> Mandat arkëtimi, datë 31.12.2012, në Bankën Tirana, për pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja në vitin 2012, në shumën 24.000 lekë.

Komisioneri, rezulton pozitive, gjë e cila, sipas subjektit, tregon se ka pasur mjaftueshëm të ardhura për të mbuluar shpenzimet e deklaruara për pasurinë e krijuar.

**16.12** Në analizën financiare të kryer në Kolegj, janë konsideruar si të ardhura të ligjshme me burim nga qiradhënia e lokalit “{\*\*\*}”, Përmet, vetëm ato të ardhura për të cilat tatimi mbi të ardhurat nga qiratë është paguar në periudhën në të cilën kjo e ardhur është krijuar, duke lënë pa përfshirë të ardhurat të cilat janë paguar gjatë procesit të rivlerësimit. Në jurisprudencën<sup>22</sup> e konsoliduar të Kolegjit, është mbajtur qëndrim se, bazuar në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon: [...] *Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore [...]*, për qëllim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë, si të ardhura të ligjshme duhen konsideruar vetëm të ardhurat të cilat plotësojnë në mënyrë kumulative këto dy kriteret: (i) që janë deklaruar; dhe (ii) për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi. Në konsideratë edhe të qëndrimit<sup>23</sup> orientues të Kolegjit, sipas të cilit vlerësimi i legjitimitetit të të ardhurave të krijuara do të vlerësohet duke konsideruar disa rrethana: *Së pari, duhet që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera. Së dyti, në konsideratë të organeve të rivlerësimit duhet të mbahet sjellja e subjektit apo e personave të lidhur dhe e personave të tjerë të lidhur në raport me mospagimin në kohë të tyre. Brenda këtij kriteri, do të duhet të vlerësohen rrethanat që kanë shkaktuar mospagimin në kohë të detyrimit për të përcaktuar nëse mospagimi ka qenë pasojë e ndonjë pakujdesie apo paqartësie apo një qëllim për t’u arritur [...]*, Kolegji vlerësoi të mos konsiderohen si të ligjshme të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, me burim nga qiradhënia e lokalit “{\*\*\*}”, të ndodhur në Përmet, për të cilat detyrimet tatimore rezultojnë se janë paguar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur gjatë dhe për qëllim të procesit të rivlerësimit. Ky konkluzion arrihet për arsye se nga aktet e çështjes, rezultoi se vetëm personi i lidhur A. A. ka paguar personalisht për disa vite detyrimet tatimore për të ardhurat nga qiraja e lokalit “{\*\*\*}” dhe nuk rezulton që ato të jenë paguar për ndonjë vit nga qiramarrësi, duke treguar se personi i lidhur ka pasur dijeni për ekzistencën e tyre para procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit.

**16.13** Si rrjedhojë e sa më sipër, Kolegji vlerësoi se, duke mos konsideruar si të ardhura nga burime financiare të ligjshme huan e dhënë nga nëna e subjektit të rivlerësimit dhe të ardhurat e përfituara nga qiraja e lokalit në Përmet, shuma prej 563.009 lekësh, si shumatore e këtyre dy burimeve, nuk mund të konsiderohet si e ardhur me burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se mungesa e burimeve financiare të ligjshme në shumën 563.009 lekë, për krijimin e pasurisë apartament banimi në Tiranë, si dhe balanca negative e analizës financiare të vitit 2010, në vlerën 208.819 lekë, të rezultuar nga analiza financiare e Komisionit dhe të pretenduar në ankim nga Komisioneri Publik, e vendosin subjektin e rivlerësimit

<sup>22</sup> *Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2019 (JR), datë 28.02.2019, paragrafi 21.12; nr. 23/2020 (JR), datë 25.09.2020, paragrafi 25.4; nr. 35/2021 (JR), datë 23.11.2021, paragrafi 18.6.*

<sup>23</sup> *Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 15/2021 (JR), datë 18.06.2021, paragrafi 23.*

në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, por në këndvështrim të nenit 52, pika 1 e të njëjtit ligj, nuk gjendemi në kushtet për zbatimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

#### *Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e aftësive profesionale*

17. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, nga Komisioni është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, bazuar në raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
18. Komisioneri Publik pretendoi në ankim se lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, për subjektin e rivlerësimit, znj. Andoni, kanë rezultuar disa mangësi. Referuar burimeve të vlerësimit sipas ligjit nr. 96/2016, raport-vlerësimit të IKLD-së, si dhe hetimit administrativ të Komisionit, problematikat dhe mangësitë e gjetura konsistojnë referuar të dhënave për 4 dosje, prej të cilave në dosjet me nr. 1, nr. 3 dhe nr. 4 (të numëruara sipas raportit të vlerësimit të IKLD-së, nga pesë dosjet e shortuara) objekt vlerësimi sipas nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se vendimet e ndërmjetme arsyetohen në nivelin minimal dhe në përgjithësi atyre u mungon referenca ligjore. Komisioneri Publik pretendon se subjekti i ka arsyetuar vendimet gjyqësore jashtë afatit ligjor, nuk disponon me vendim/urdhër formal për caktimin e seancës gjyqësore dhe nuk kujdeset që aktet e njoftimit të përfshihen rregullisht në dosje. Mangësitë në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të janë të njëjta në dosjet e vëzhguara, si: aktet e njoftimit të palëve mungojnë në dosje apo nuk përfshihet në dosje lista e shpalljeve, nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes etj. Gjithashtu, lidhur me këto dosje, është konstatuar vonesë në depozitim të tyre në sekretarinë gjyqësore. Ndërsa për dosjet nr. 2 dhe nr. 3, subjekti nuk disponon me vendime të ndërmjetme. Në pjesën hyrëse të vendimit, mungon data e regjistrimit të çështjes në gjykatë, gjeneralitetet e plota të palëve apo aktet e përfaqësimit të tyre.

**18.1** Lidhur me tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioneri Publik pretendon se çështjen civile, me palë A. Z. dhe K. K., regjistruar më datë 08.04.2013 dhe përfunduar më datë 29.04.2014, periudhë nga e cila, pas marrjes së çështjes nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e relatores, çështja ka zgjatur 9 muaj e 20 ditë, në tejkalim të afatit 6-mujor të gjykimit civil, të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010, “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, të KLD-së. Çështja penale me të pandehurin A. N., regjistruar më datë 12.03.2014 dhe përfunduar më datë 19.02.2015, ka zgjatur 11 muaj e 7 ditë, edhe kjo në tejkalim të afatit 6-mujor të parashikuar për gjykimet penale në Gjykatën e Apelit. Tejkalim në afatet e gjykimit janë konstatuar edhe për raste të tjera, pasi nga burimet arkivore të KLD-së, ka rezultuar, ndër të tjera, se janë regjistruar tri ankesa të vitit 2016, të cilat, pasi janë verifikuar për zvarritje gjykimi, në përfundim janë regjistruar për vlerësim profesional dhe etik për subjektin e rivlerësimit. Komisioneri Publik, mbështetur në standardet e përcaktuara në nenin 74 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, vlerëson se është përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit që për secilin rast të trajtuar,

duhet të kishte marrë masa për të shmangur shkeljen e afateve të gjykimit të çështjes, të arsyetonte vendimet e ndërmjetme me bazën ligjore përkatëse, të kujdesej për aktet dhe efektivitetin e njoftimit të palëve, arsyetimit në kohë të vendimeve dhe dorëzimit të dosjeve, verifikimit të plotësisë dhe korrektësisë së dosjeve gjyqësore, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të procesit gjyqësor. Në përfundim, Komisioneri Publik pretendoi se, duke i marrë së bashku këto gjetje, përfshirë dhe çështjen civile me nr. akti {\*\*\*}, të vitit 2015, të transferuar nga Komisioni pranë organit kompetent për inspektim, sipas nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve, mund të çojnë në një vlerësim të ndryshëm nga sa ka arritur Komisioni.

**18.2 Konkluzionet e Komisionit lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale:** [...] Komisioni, duke mbajtur në konsideratë se kjo ka qenë e vetmja çështje ku janë evidentuar shkelje procedurale të kësaj natyre, i është referuar vendimit nr. 2 /2017 të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit: “Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale”. Për rrjedhojë, nuk e çmoi këtë rast si shkak për vlerësim negativ të aftësive profesionale të znj. Miranda Andoni, por çmoi ta transferojë këtë çështje pranë organit kompetent për inspektim për shkaqet e analizuar më lart.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimit të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit: a) ka aftësi për të gjykuar; b) ka aftësi të pranueshme organizative, për shkak se mangësitë e evidentuara nuk kanë rezultuar në mosrespektim të të drejtave të palëve apo mungesë jo të pranueshme efience ose efektiviteti; c) e ka zhvilluar veprimtarinë gjyqësore në përputhje me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore; dhe ç) ka demonstruar cilësi personale dhe angazhim profesional, në përputhje me standardet e parashikuara në ligj.

Në përfundim të rivlerësimit profesional, të kryer sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, referuar neneve 72, 74, 75, 76 dhe 77 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pas propozimit të relatores, Komisioni vlerësoi që subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, ka arritur nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, duke u konsideruar “E aftë”.

Lidhur me gjetjet e raportit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për vlerësimin e 5 dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe objektiv, Komisioneri Publik ka përfshirë në ankim gjetjet që kanë rezultuar për katër<sup>24</sup> dosje, si vijojnë.

**18.3 Dosja 1:** Çështja civile nr. {\*\*\*} regj. them., datë 08.09.2013, që i përket kërkuarit B. H. dhe personit të tretë Ç. I., me objekt “rivendosje në afat të kërkesës për ankim ndaj vendimit gjyqësor nr. {\*\*\*}, datë 10.12.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, e përfunduar me vendimin

<sup>24</sup> Komisioneri Publik në seancën gjyqësore publike në Kolegj, parashitroi si dosje të rezultuar me mangësi edhe atë me nr. 5 sipas raportit profesional të IKLD-së, pretendim të cilin nuk e ka paraqitur në ankim, për këtë arsye trupi gjyqësor, bazuar në nenin 465, pika 1 e K.Pr.Civile, këtë shkak ankimi nuk ia nënshtroi shqyrtimit në Kolegj.

nr. 539, datë 31.10.2013. Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, në këtë çështje ishte në cilësinë e anëtares së trupit gjykues.

Në raportin profesional lidhur me këtë çështje, ndër të tjera janë evidentuar disa mangësi, si vijojnë. Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit në datën 20.11.2013, jashtë afatit ligjor 10-ditor të përcaktuar nga neni 308, paragrafi 2 i K.Pr.Civile. Janë kryer veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, por ato nuk janë dokumentuar rregullisht. Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar, ka disa të meta. Nuk gjenden në dosje akte për njoftimin e seancës së parë gjyqësore dhe për njoftimin e palëve. Vendimet e ndërmjetme janë arsyetuar mjaftueshëm dhe nuk përmbajnë në çdo rast referenca ligjore. Nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes. Aktet në dosje nuk janë të inventarizuara. Në përfundim të vlerësimit për këtë çështje, është shënuar se vendimi është i kuptueshëm dhe i argumentuar.

**18.4 Dosja 2:** Çështja civile nr. {\*\*\*} regj. them., datë 17.07.2014, që i përket paditëses K. Xh., me objekt zgjidhje martese, e përfunduar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.09.2014. Subjekti i rivlerësimit në këtë çështje ishte në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues. Mangësitë që janë konstatuar nga raporti profesional kanë të bëjnë me mungesën e dokumentimit të veprimeve procedurale dhe organizimin e procesit gjyqësor. Në dosje nuk ka akte njoftimi apo listë shpallje, edhe pse subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore për shqyrtimin e kësaj çështjeje deklaroi se paditësi, paditësja dhe mbrojtësit e tyre kanë marrë dijeni nëpërmjet shpalljes. Subjekti i rivlerësimit ka vendosur vazhdimin e gjykimit në mungesë të palëve. Pas pak minutash, në sallë është paraqitur përfaqësuesi me prokurë të palës së paditur, ku pasi bëhet prezent trupi gjykues, i jepet fjala mbrojtësit pa u revokuar vendimi i gjykimit në mungesë, si dhe pa u cituar prokura me të cilën mbrojtësi ka marrë tagrat e përfaqësimit nga pala që mbron e përfaqëson. Mbrojtësi gjatë kësaj seance ka deklaruar se nga gjykata e shkallës së parë është shkelur rregulli procedural i Kodit të Familjes, pasi fëmija mbi 10 vjeç nuk është pyetur në prani të një specialisti. Subjekti i rivlerësimit, pa disponuar me vendim, nuk e ka pranuar kërkesën për pyetjen e fëmijës, duke evidentuar se është marrë mendimi i punonjësit social nga gjykata e shkallës së parë. Më pas gjykata është tërhequr për vendim dhe në kthim, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

**18.5 Dosja 3:** Çështja penale nr. {\*\*\*} regj. them., datë 03.07.2015, që i përket kërkuesit {\*\*\*} kundër të pandehurit Xh. M., i akuzuar për veprat penale të “shitjes së narkotikëve”, të “kultivimit të bimëve narkotike”, të “mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, të “mbajtjes pa leje të armëve të ftohta” dhe të “mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 283, paragrafi 1; 284, paragrafi 1; 278, paragrafi 2; 279, paragrafi 1 dhe 280 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 10.09.2015. Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, në këtë çështje ishte në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues.

Mangësitë që janë evidentuar në raportin profesional lidhur me këtë çështje, janë si në vijim. Në seancën e parë gjyqësore që i përket kësaj çështjeje, evidentohet se me kërkesë të prokurorit, gjykata me vendim të ndërmjetëm, pa referencë ligjore, zëvendëson mbrojtësin, duke caktuar kryesisht një mbrojtës tjetër dhe për thirrjen e këtij të fundit, ka shtyrë seancën përtej afatit 15-

ditor. Në seancën e tretë gjyqësore, gjykata sërish me vendim të ndërmjetëm, pa referencë ligjore, shtyn seancën, por brenda afatit 15-ditor. Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i K.Pr.Penale. Janë kryer veprime procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, por ato nuk janë dokumentuar rregullisht. Në përfundim të evidentimeve për këtë çështje, ka rezultuar se vendimi është i kuptueshëm dhe i argumentuar.

**18.6** Dosja 4: Çështja civile nr. {\*\*\*} regj. them., datë 27.11.2015, që i përket paditësit “{\*\*\*}” ShA, kundër të paditurit “{\*\*\*}” ShPK, me objekt përmbushje detyrimi monetar, e përfunduar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 09.02.2016. Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, në këtë çështje ishte në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues. Në raportin profesional për këtë çështje, është evidentuar se vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit në datën 22.02.2016, me 3 ditë jashtë afatit ligjor 10-ditor, të parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile.

**18.7** Në apelin kundërshtues të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, ka kundërshtuar se shkaqet e parashtruara në ankim nga Komisioneri Publik në lidhje me këtë kriter, janë vlerësuar nga Komisioni dhe është konkluduar se subjekti ka arritur nivelin minimal kualifikues duke e konsideruar “e aftë” dhe në të kundërt vlerësimi do të ishte në një nivel më të lartë. Në asnjë prej çështjeve nuk ka pasur shkelje të tilla që të çojnë në një konkluzion të ndryshëm, më të ulët se konkluzioni i arritur në këtë vendim. Lidhur me vlerësimin e Komisionerit Publik se tejkalimi i afateve është vërejtur më shumë se një herë, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se tejkalimi afateve të gjykimit nuk është një normalitet në veprimtarinë e saj gjyqësore, përkundrazi në tërësinë e gjykimeve, çështjet të cilat subjekti ka pasur relatimin, kohëzgjatja e gjykimeve është brenda afatit të arsyeshëm. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se në asnjë çështje nuk ka qenë shkak për shtyrjen e seancave gjyqësore dhe se çdo seancë e zhvilluar ka qenë e dobishme dhe në funksion të zgjidhjes objektive të çështjes.

**18.8** Kolegji vëren se në shqyrtimin e këtij shkak ankimi, për efekt të identifikimit të fakteve dhe rrethanave të cilat mund të përbëjnë provë në procesin e rivlerësimit, janë mbajtur në konsideratë dispozitat e zbatueshme kushtetuese dhe ligjore për trajtimin dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Konkretisht, referuar nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i aftësive profesionale për gjyqtarët përfshin aftësinë për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, bazuar në standardet e parashikuara në ligj. Këto kriter vlerësimi do duhet të shqyrtohen nga ana e institucioneve të rivlerësimit sipas zbërthimit që i është bërë secilit prej tyre në nenet 72-76 të ligjit nr. 96/2016. Në përputhje me këto dispozita, vihet re se vlerësimi i aftësive profesionale konsiston në një proces analize të të dhënave të marra nga një sërë burimesh, të dhëna këto, rezultatja e të cilave do duhet të nxjerrë një tregues lidhur me ecurinë profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe nga ku mund të identifikohet përkatësia e tij në një nga nivelet e kualifikimit të përcaktuara në nenin 44 të ligjit nr. 84/2016.

**18.9** Duke u nisur nga shkaqet e ankimit, Kolegji konstaton se në pjesën e vlerësimit të aftësive profesionale, referuar burimeve të ligjit nr. 84/2016 e të ligjit nr. 96/2016, në të cilën janë

përcaktuar e përshkruar aftësitë e subjektit sipas kriterëve të vlerësimit parashikuar në nenet 72-76 të ligjit nr. 96/2016, gjetjet referohen si mangësi profesionale të subjektit që lidhen me aftësitë organizative, e konkretisht: i) me arsyetimin e vendimit me vonesë, jashtë afatit ligjor, si gjetje të dosjeve 1, 3 dhe 4; ii) janë kryer veprime procedurale, por këto nuk janë dokumentuar, si gjetje në dosjet 1 dhe 3; iii) nuk gjenden në dosje akte të njoftimit të palëve, edhe pse në procesverbalet e seancave gjyqësore referohet se kanë marrë njoftim, si gjetje në dosjet 1 dhe 2; iv) vendimet e ndërmjetme nuk përmbajnë referenca ligjore, si gjetje të dosjeve 1 dhe 3. Gjithashtu në tri dokumentet<sup>25</sup> nga tri të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, vërehet se në raportin profesional është shënuar e njëjta gjetje (pavarësisht se Komisioneri Publik ka ankuar dy nga tri dokumentet e zgjedhura prej subjektit), që konsiston në faktin se në tekstin e vendimit (si dokument i përzgjedhur nga subjekti), nuk është shënuar data e regjistrimit të çështjes, rrjedhimisht kohëzgjatja e gjyqimit të kësaj çështjeje nuk mund të përcaktohet. Gjithashtu, në raport është konstatuar se nuk janë përlloritur shpenzimet gjyqësore, si dhe nuk shpjegohet e drejta e rekursit sipas nenit 476 të K.Pr.Civile.

**18.10** Komisioni, lidhur me gjetjet e raportit profesional, i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, i cili në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se: “Në përgjithësi jam dakord me gjetjet. [...] sa u përket gjetjeve për aftësinë organizative, në lidhje me afatin e arsyeimeve të vendimeve gjyqësore janë konstatuar raste që janë arsyetuar me vonesë dhe kjo ka ardhur për shkak të ngarkesës në punë. Gjithashtu, këto vonesa kanë qenë shumë afër kufirit kohor brenda të cilit duhej të arsyetoheshin vendimet, disa ditë, por nuk kanë qenë përtej afatit të ushtrimit të së drejtës së rekursit për në Gjykatën e Lartë. Në pjesën më të madhe, gjykimet zhvillohen dhe përfundojnë në seancën e planifikuar. Shtyrjet e seancave kanë ardhur si pasojë e kërkesave të palëve ose kryerjes së hetimit të pjesshëm. Asnjëherë nuk kam qenë shkak për shtyrjen e seancave gjyqësore. Ndërsa lidhur me fillimin e gjykimeve jo në orarin e planifikuar, ka ardhur si rrjedhojë e tejkalimit të kohës së planifikuar në gjykimet e mëparshme, pasi nuk rezulton që gjykimet të kenë filluar me vonesë për shkaqe subjektive”.

**18.11** Kolegji vëren se në shqyrtim të këtij shkak ankimi të ngritur nga Komisioneri Publik, nga verifikimi i akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, konstatohet se në çështjen e referuar “dosja 1” më sipër, subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, në gjykimin e kësaj çështjeje civile paraqitet në cilësinë e anëtares së trupit gjykues. Sa i takon kriterit të “aftësive organizative”, vlerësohet se në rastet e gjyqimit të çështjeve në trup gjykues, përgjegjësia e gjyqtarit në përmbushjen e afateve ligjore duhet vlerësuar në raport me rolin dhe cilësinë e tij në trupin gjykues, duke mbajtur në konsideratë në këtë drejtim edhe dispozitat e legjislacionit procedural civil apo/dhe penal lidhur me kompetencat dhe përgjegjësitë e kryesuesit të trupit gjykues në administrimin dhe drejtimin e procesit gjyqësor. Jo pa qëllim çështjet e shortuara dhe ato të përzgjedhura nga subjektet për efekt të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, në rastet

---

<sup>25</sup> - Dokumenti 1, vendimi nr. {\*\*\*}, datë 29.04.2014, i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë;  
- Dokumenti 2, vendimi nr. {\*\*\*}, datë 19.02.2015, i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë;  
- Dokumenti 3, vendimi nr. {\*\*\*}, datë 11.05.2016, i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.



kur gjykimi bëhet në mënyrë kolegjiale, u korrespondojnë zakonisht çështjeve ku subjektet kanë pasur cilësinë e gjyqtarit kryesues (relator) të çështjes. Për këtë çështje, lidhur me kohëzgjatjen e arsyetimit të vendimit, nisur nga data e përfundimit të gjykimit të saj në Gjykatën e Apelit Gjirokastër e deri ditën e arsyetimit të vendimit, duke qenë se subjekti i rivlerësimit ishte në cilësinë e anëtarit dhe jo kryesuesit të trupit gjykues, shihet si jo me relevancë të drejtpërdrejtë në vlerësimin e aftësive organizative të subjektit të rivlerësimit, ndaj ky rezultat nuk cenon vlerësimin e subjektit për këtë rast.

**18.12** Lidhur me çështjet e subjektit të rivlerësimit ku ka rezultuar si “mangësi”, arsyetimi i vendimit me vonesë pak ditë pas afatit të përcaktuar me ligj, janë shkelje që u përkasin aftësive organizative të gjyqtarit, parashikuar nga neni 74 i ligjit nr. 96/2016. Kjo situatë ka të bëjë me efektivitetin dhe produktivitetin e gjyqtarit, nëpërmjet të cilëve vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të qenë efektiv në zgjidhjen e çështjeve që i janë caktuar për gjykim në aspektin cilësor dhe sasior, në raport me kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore të përcaktuara nga vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe për të qenë produktiv në arsyetimin e dorëzimit e vendimeve brenda afateve ligjore.

**18.13** Kolegji vëren se, sa i përket respektimit të afateve ligjore, kjo duhet parë edhe brenda kompetencave funksionale që ushtron gjyqtari i gjykatës së apelit, rrethanë e cila vlerësohet proporcionalisht në raport edhe me treguesit e tjerë brenda kriterit të aftësive organizative, sikurse rendimenti dhe ngarkesa në punë. Në raportin profesional<sup>26</sup> që i përket subjektit të rivlerësimit, në rubrikën “Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore”, rezulton se gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, ka ushtruar funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Gjirokastër dhe ka gjykuar çështje civile (të përgjithshme, familjare, administrative, tregtare) dhe çështje penale (krime, kundërvajtje, masa sigurimi dhe penale të veçanta), pasi kjo gjykatë, për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve, nuk ka qenë e organizuar në dhoma apo seksione të veçanta gjykimi. Pra, nga kjo statistikë e nxjerrë në raportin profesional, rezulton se subjekti i rivlerësimit praktikisht ka gjykuar në të gjitha seksionet e gjykimit në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, duke pasur kështu një ngarkesë të tejshtuar për shkak të përfshirjes në gjykime të çështjeve të natyrave të ndryshme. Një vendim i arsyetuar u tregon palëve se çështja e tyre është dëgjuar dhe vlerësuar, lejon vlerësimin e publikut ndaj sistemit të drejtësisë dhe është një kërkesë e domosdoshme për të përgatitur një ankim të qenësishëm dhe në mënyrë efektive. Gjithsesi në këto çështje, nga subjekti i rivlerësimit, janë shkelur afatet ligjore për arsyetimin e vendimit, por duke konsideruar dinamikën dhe ngarkesën e punës në gjykatat e apeleve, vonesa me disa ditë për arsyetimin e vendimit duket se e humbet relevancën për trajtimin e saj, si një mangësi e vlefshme për t’u evidentuar në drejtim të aftësive organizative të subjektit.

**18.14** Gjithashtu, lidhur me çështjet (dosja 1 ku subjekti ishte në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues dhe dosja 3 ku subjekti ishte në cilësinë e kryesuesit të trupit gjykues) është konstatuar se janë kryer veprime procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, por ato nuk janë dokumentuar rregullisht, kanë të bëjnë me mungesën e disponimit me vendim formal për zëvendësimin e

---

<sup>26</sup> *Shih faqen 2 të raportit profesional të IKLD-së.*

mbrojtësit, dokumentimin e prokurës, si dhe revokimin e vendimit për vazhdimin e gjykimit në mungesë të palëve. Lidhur me çështjet në të cilat mungojnë aktet e njoftimit të palëve, konkretisht në dosjen 1 dhe 2 të çështjeve të shortuara, ku vetëm në dosjen 2, subjekti i rivlerësimit ka qenë në rolin e kryesuesit të trupit gjykues, vlen të theksohet se sistemimi i dosjeve nuk është detyrë funksionale e gjyqtarit, gjithsesi nga verifikimi i akteve që ndodhen në dosje, vërehet se në procesverbalin gjyqësor është shënuar se palët në proces që u përkasin këtyre çështjeve, janë njoftuar. Në procesverbalin, datë 16.10.2013, që i përket dosjes 1, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, citohet se u thirr dhe nuk u paraqit personi i tretë, njoftimi është kryer me shpallje dhe konsiderohet i njoftuar. Në dosje nuk është administruar shpallja e kryer për njoftimin e personit të tretë. Sa i përket dosjes 2, nga verifikimi i akteve që gjenden të administruara në fashikullin gjyqësor që i përket kësaj çështjeje, rezulton se në seancën e datës 23.09.2014, subjekti i rivlerësimit çel seancën gjyqësore dhe pasi bën verifikimin e prezencës së palëve, evidenton se paditësi, i padituri dhe mbrojtësit e tyre nuk janë paraqitur, ndërkohë subjekti i rivlerësimit evidenton në këtë procesverbal se njoftimi është kryer me shpallje dhe konsiderohen të njoftuar. E njëjta situatë faktike përsëritet edhe në dosjen 4.

**18.15** Për çështjen që është referuar si dosja 3, nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, rezultoi se subjekti i rivlerësimit në këtë çështje ishte në cilësinë e kryesuesit të trupit gjykues. Në raportin profesional, sa i përket kësaj çështjeje, është evidentuar se në vendimin e ndërmjetëm për caktimin e avokatit kryesisht mungon referenca ligjore, si dhe veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor nuk janë dokumentuar rregullisht në dosje. Në vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 261/2, datë 14.04.2010, në nenin 12 të tij, “Aftësia për të krijuar dhe administruar një dosje”, është parashikuar se me këtë kriter vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të krijuar një dosje gjyqësore, duke strukturuar qartë aktet përbërëse të saj, që të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme.

**18.16** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, në fashikullin gjyqësor konstatohet se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kryesuesit të trupit gjykues, në procesverbalin e seancës gjyqësore, datë 22.07.2015, pasi ka konstatuar se avokati i caktuar kryesisht nuk ishte paraqitur në seancë dhe nuk kishte paraqitur arsye të ligjshme, ka caktuar një mbrojtës tjetër dhe ka shtyrë seancën gjyqësore për njoftimin e tij. Lidhur me këtë vendim, në raportin profesional e më tej, edhe Komisioni ka konstatuar se nuk ka referencë ligjore. Neni 342 i K.Pr.Penale, me titull “Gjykimi i pandërprerë”, në pikat 1 dhe 2 të tij parashikon se kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të përfundohet në një seancë të vetme, gjykata vendos që të vazhdojë ditën e mëpasme të punës. Shtyrja dhe ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor shpallen nga kryetari në seancë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka përmendur bazën ligjore për shtyrjen e kësaj seance, por ka dhënë arsyet e shtyrjes së saj. Meqë avokati i caktuar kryesisht ka pasur dijeni rregullisht dhe nuk ka paraqitur arsye për mungesën e tij, subjekti i rivlerësimit ka caktuar një mbrojtës tjetër dhe ka shtyrë seancën për njoftimin e tij, duke garantuar kështu moszvarritjen e gjykimit, si dhe për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive. Sa më sipër referuar, rezultoi se ky vendim i ndërmjetëm, të cilin subjekti

i rivlerësimit e ka marrë në seancë gjyqësore, nuk përmban referencë ligjore si dhe nuk argumenton arsyet e kësaj vendimmarrjeje.

**18.17** Lidhur me këtë situatë faktike, Kolegji vlerëson se në një proces gjyqësor, palët duhet të qartësohen për çka ndodh gjatë seancës gjyqësore dhe kjo qartësi duhet të burojë nga argumentimi i vendimmarrjes së gjykatës si dhe mbështetja e saj në ligj, duke garantuar për palët qartësi dhe kuptueshmëri gjatë seancave gjyqësore. Arsyetimi ligjor i vendimit është një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, i cili ka për qëllim: a) ushtrimin e kontrollit gjyqësor nga një gjykatë më e lartë; dhe b) ushtrimin e kontrollit publik në administrimin e drejtësisë.

Sidoqoftë, kjo situatë e subjektit të rivlerësimit është e lidhur me arsyetimin e vendimeve të ndërmjetme në seancat gjyqësore që u përkasin çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit dhe jo vendimeve përfundimtare të arsyetuara nga subjekti. Vlen të theksohet se në të gjitha çështjet që i janë vlerësuar subjektit të rivlerësimit në raportin profesional të IKLD-së, vendimet përfundimtare janë vlerësuar të kuptueshëm dhe të argumentuar.

**18.18** Lidhur me dy nga tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit për t'ia nënshtruar vlerësimit të aftësive profesionale (cituat në paragrafin 17.1 më sipër), është konstatuar tejkalim në afatet e gjykimit, fakt në të cilin Komisioneri Publik është ndalur duke vënë theksin në vlerësimin e aftësive profesionale. Komisioneri Publik pretendon se tejkalim i këtyre afateve është konstatuar edhe për raste të tjera, pasi nga burimet arkivore të KLD-së, ka rezultuar, ndër të tjera, se janë regjistruar tri ankesa të vitit 2016, të cilat, pasi janë verifikuar për zvarritje gjykimi, në përfundim janë regjistruar për vlerësim profesional dhe etik për subjektin e rivlerësimit. Komisioneri Publik pretendoi në ankim se, bazuar në gjetjet dhe mangësitë e konstatuara nga IKLD-ja, të konfirmuara dhe nga hetimi administrativ i Komisionit, Kolegji duhet të analizojë faktin e konstatuar të tejkalimit të afateve të gjykimit, si model i vërejtur në më shumë se një herë në veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, pasi ky fakt së bashku dhe me mangësitë e tjera, në këndvështrim të nenit E, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, përbën cenim të së drejtës së qytetarëve për një gjykim brenda afateve të arsyeshme.

**18.19** Lidhur me sa më sipër pretenduar, Kolegji sjell në vëmendje se zhvillimi i procesit brenda afateve të arsyeshme është një parim kushtetues, respektimi i të cilit mundëson realisht vënien në vend të të drejtave të personave. Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm rrjedh nga detyrimi i përcaktuar në nenin 42, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe është komponent i nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

**18.20** Nisur nga kuptimi i këtij parimi, gjykata duhet të insistojë që procedura të zhvillohet pa zvarritje, brenda afatit të arsyeshëm, me sa më pak shpenzime, si dhe të pamundësojë çdo keqpërdorim të të drejtave që u takojnë palëve në një gjykim. Gjykimi brenda afateve të arsyeshme lidhet edhe me kriterin e ekonomisë gjyqësore, pasi një proces i shpejtë dhe efektiv do të shmangte shpenzime gjyqësore të panevojshme për palët. Nëse një afat është i arsyeshëm ose jo, vlerësohet nga rasti në rast. Për të evidentuar nëse ka qenë e arsyeshme kohëzgjatja e një procesi gjyqësor,

duhet të merret në konsideratë veçanërisht natyra e ndërlikuar e çështjes, sjellja e palëve dhe ajo e autoriteteve kompetente administrative dhe gjyqësore.

**18.21** Në vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010, “Për sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve”, në aneksin 1 të tij, janë përcaktuar kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore.

Në pikën 5 të aneksit parashikohet:

*Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si më poshtë:*

[...]

*g. Gjykimet penale në gjykatën e apelit, jo më tej se 2 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 6 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.*

*h. Gjykimet civile në gjykatën e apelit, jo më tej se 6 muaj. [...]*

**18.22** Për çështjen që i përket vendimit nr. {\*\*\*}, datë 29.04.2014, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, me paditës/kundërpaditur A. Z. kundër të paditurit/kundërpaditës K. K., me objekt “Kallëzim i një punimi të ri”, me vërtetimin nr. {\*\*\*} prot., datë 11.02.2020, të lëshuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në Komision, u vërtetua se çështja është regjistruar në datën 08.04.2013 dhe ka përfunduar në datën 29.04.2014. Sipas dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se çështja ka pasur si relatore fillimisht gjyqtaren M. Q. dhe më pas i ka kaluar gjyqtarës Miranda Andoni në datën 09.07.2013. Sipas këtij vërtetimi, kohëzgjatja e këtij gjykimi ka qenë 9 muaj e 20 ditë.

**18.23** Lidhur me këtë konstatim, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, barrën e provës për të dhënë shpjegime për vonesat në gjykim, e cila në shpjegimet datë 10.03.2020 mbi rezultatet e hetimit ka sqaruar: *Nga aktet e dosjes, rezulton se jam futur në këtë proces në zëvendësim të gjyqtarës M. Q. (emëruar në Gjykatën e Apelit Tiranë), në cilësinë e relatores dhe pasi jam njohur me dosjen kam pranuar që gjykimi të vazhdojë në momentin procedural të mbetur, e pikërisht në kryerjen e ekspertimit. Në rastin në shqyrtim, çështja civile paraqitej komplekse pasi do të shqyrtoheshin njëherësh padia dhe kundërpadia, por edhe për shkak të natyrës së këtyre kërtimeve, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve në këtë proces. Pala paditëse kërkonte kallëzimin e një punimi të ri, ndërkohë i padituri kërkonte pushim cenimi të pronës. Për kryerjen e aktit të ekspertimit dhe për t'i kthyer përgjigje gjykatës, ekspertët kanë kërkuar nga gjykata sigurimin e dokumentacionit që ata kanë vlerësuar si të nevojshëm për të kryer aktin, kërkuar me kërkesë me shkrim (studim pjesor etj.), kërkesë e cila është pranuar edhe pse pala e paditur nuk ishte dakord. Me administrimin e akteve të reja shkresore gjatë gjykimit në shkallë të dytë është pretenduar në lidhje me vërtetësinë e dokumentacionit të Bashkisë Sarandë, është pretenduar falsiteti i një vendimi të KRT-së së kësaj bashkie dhe, në kushte të tilla, ka lindur nevoja dhe është kërkuar gjithë praktika dokumentare nga bashkia për dokumentacionin për të dyja palët ndërgjyqëse, me qëllim hetimin në lidhje me këtë kërkim. Gjatë gjykimit, pati debat në lidhje me dokumentacionin e lëshuar nga Bashkia Sarandë, ku prej palëve është pretenduar se*

*dokumentacioni i ndodhur në dosje nuk ishte i njëjti me dokumentacionin që paraqiste pala paditëse, lëshuar nga Bashkia Sarandë. Pati shumë debat në lidhje me vërtetësinë e dokumentacionit të lëshuar nga Bashkia Sarandë dhe është kërkuar nga bashkia çdo dokument që ka qenë i domosdoshëm për të konkluduar në lidhje me pretendimet për vërtetësinë e tyre. Gjatë gjykimit vetëm një seancë gjyqësore nuk është zhvilluar, për shkak të mosparaqitjes sime për shkaqe shëndetësore (është depozituar raporti mjekësor).*

**18.24** Pasi verifikoi procesverbalet e seancave gjyqësore, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni konstatoi se tejkalimi i afateve në gjykimin e çështjes ka ardhur për shkaqe të justifikueshme e të rrethanave, si vijojnë: (i) subjekti ka hyrë në proces tre muaj më vonë nga data e regjistrimit të çështjes, duke zëvendësuar gjyqtaren e parë relatore të çështjes, pretendim i provuar me vërtetimin nr. {\*\*\*} prot., datë 11.02.2020, të lëshuar nga kancelari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë; (ii) kompleksiteti i çështjes për shkak të shqyrtimit njëherësh të padisë dhe kundërpadisë (paditësi kërkonte kallëzim punimi të ri, kurse i padituri kërkonte pushim cenimi të pronës); (iii) kërkimet e palëve dhe ekspertëve të thirrur gjatë procesit gjyqësor; (iv) një seancë gjyqësore nuk është zhvilluar për shkak të mosparaqitjes së subjektit për arsye shëndetësore, duke paraqitur raport 5-ditor për paftësi të përkohshme në punë.

**18.25** Kolegji, pasi analizoi procesverbalet e këtij fashikulli gjyqësor, që gjenden të administruara në dosjen e Komisionit, verifikoi arsyet e shtyrjes së procesit gjyqësor në të gjitha seancat e zhvilluara të kësaj çështjeje, për t'u qartësuar nëse shtyrja ka ardhur për arsye objektive dhe që nuk vareshin prej subjektit të rivlerësimit, apo për arsye subjektive dhe që mund të kenë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit jashtë afateve të parashikuara nga KLD-ja.

**18.26** Nga procesverbalet gjyqësore vërehet se më datë 23.07.2013, seanca gjyqësore shtyhet pasi u është dhënë mundësia ekspertëve (ishin caktuar 2 të tillë) për të kryer aktin e ekspertimit (në këtë çështje subjekti i rivlerësimit ka hyrë pas zëvendësimit të gjyqtarës M. Q.). Më datë 24.09.2013, shtyhet seanca gjyqësore pasi ekspertët nuk kanë përfunduar aktin e ekspertimit dhe kërkojnë kohë shtesë. Më datë 08.10.2013, kërkohet shtyrje e gjykimit nga mbrojtësi i palës paditëse, pasi kërkon të njihet me aktin e ekspertimit. Më datë 08.11.2013, seanca gjyqësore është shtyrë pasi pjesa më e madhe e aktit të ekspertimit është kryer nga eksperti, i cili nuk është paraqitur në gjykim pasi për arsye pune, ndodhej në prokurori. Më datë 19.11.2013, shtyhet seanca gjyqësore me kërkesë me shkrim të avokatit të palës paditëse, i cili ka paraqitur dhe raport mjekësor. Më datë 10.12.2013, shtyhet seanca për arsye se gjykata ka vlerësuar të marrë praktikën për dhënien e lejes së ndërtimit nga Bashkia Sarandë. Më datë 14.01.2014, shtyhet seanca pas kërkesës me shkrim të mbrojtësit të paditurit për një rast fatkeqësie të ndodhur jashtë Shqipërisë. Më datë 28.01.2014, shtyhet seanca me kërkesë të mbrojtjes së palës së paditur për të kërkuar dokumentacion nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Sarandë. Më datë 11.02.2014, seanca është shtyrë për shkak të arsyeve shëndetësore të subjektit të rivlerësimit, ku ka paraqitur dhe raport mjekësor. Më datë 25.02.2014, shtyhet seanca gjyqësore për t'u lënë kohë palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare. Më datë 04.03.2014, shtyhet seanca gjyqësore me kërkesë të palës së paditur për përjashtimin e trupit gjykues. Më datë 18.03.2014, shtyhet seanca se nuk është formuar trupi gjykues që do të

gjykojë kërkesën për përjashtim, pasi nuk është caktuar ende gjyqtari nga KLD-ja, duke qenë se ish-in pak gjyqtarë që ushtronin funksionin në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë. Më datë 15.04.2014, shtyhet seanca pasi rezulton se pala paditëse nuk ka konfirmim nëse ka dijeni për datën e seancës. Më 22.04.2014, shtyhet seanca gjyqësore për shkak se një anëtar i trupit gjykues ka pasur rast fatkeqësie. Më datë 29.04.2014, është shpallur vendimi i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

**18.27** Nga rrethanat e konstatuara si më sipër renditur, Kolegji vlerëson se standardi i gjykimit në një afat të arsyeshëm duhet të vlerësohet në mënyrë të veçantë për çdo rast konkret. Për të verifikuar nëse është shkëlur parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata Kushtetuese<sup>27</sup> aplikon kriteret që ka vendosur Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”), e cila në këtë drejtim ka adaptuar një trajtim *in concreto*, duke u shprehur se: “Arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh, sidomos, kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit, si dhe sjelljen e autoriteteve kompetente”<sup>28</sup>. Kompleksiteti i çështjes lidhet me natyrën e padisë/akuzës, numrin e personave të akuzuar, kohën e nevojshme për mbledhjen e provave dhe formulimin e akuzave, respektimin e procedurës së njoftimeve etj. Sjellja e palëve ka të bëjë me mungesën e mbrojtësit, sigurimin e provave dhe paraqitja në rregull e tyre, sjellje e cila mund të luajë një rol në vonimin e procesit gjyqësor jashtë afatit të arsyeshëm për të përfutur nga mjetet që i jep ligji.

**18.28** Në rastin si më sipër konstatuar, Kolegji vlerëson se çështja gjyqësore që gjykonte subjekti i rivlerësimit, kishte për shqyrtim padi dhe kundërpadi, të cilat praktikisht janë dy padi që trajtojnë objekte të ndryshme që i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor. Gjatë gjykimit vërehet nga procesverbali gjyqësor që ka pasur korrespondencë edhe me institucione shtetërore, siç është Bashkia Sarandë, nëpërmjet së cilës është kërkuar dokumentacion. Gjithashtu vërehet se ka një kërkesë për shtyrje gjykimi nga palët dhe në më të shumtën e seancave, kjo është arsyeja kryesore që ka zgjatur ky gjykim, pasi mbrojtësi ka kërkuar shtyrje seance dhe gjykata e ka pranuar për të garantuar të drejtën e mbrojtjes palës, gjithashtu njëra palë ka kërkuar përjashtimin e trupit gjykues dhe kjo ka marrë mjaft kohë, pasi numri i gjyqtarëve që kishte Gjykata e Apelit Gjirokastrë nuk e mbulonte krijimin e një trupe tjetër, ndaj duhej të caktohej një gjyqtar nga KLD-ja për të gjykuar kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues ekzistues. Gjithashtu, sjellim në vëmendje se ky gjykim përfshinte edhe marrje prove me ekspert, e cila kërkon kohën e saj për t’u caktuar eksperti, për t’u njohur me dosjen, punuar, dhënien palëve për t’u njohur me aktin e ekspertimit, si dhe diskutimin në seancë gjyqësore. Si rrjedhojë e sa më sipër, nga verifikimet e kryera, Kolegji çmoi se tërësia e arsyeve që kanë diktuar nevojën për shtyrjen e seancave gjyqësore dhe daljen e gjykimit jashtë afateve të parashikuara nga standardet kohore të vlerësimit nga KLD-ja<sup>29</sup>, nuk kanë ardhur si pasojë e shkaqeve të lindura nga aspektet subjektive të subjektit të rivlerësimit, por si rrjedhojë e garantimit të standardeve të komponentëve të procesit të rregullt ligjor.

<sup>27</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 18, datë 19.07.2005.

<sup>28</sup> Vendimi i GjEDNj-së, *Kemmache kundër Francës*, datë 27.11.1991.

<sup>29</sup> Vendimi nr. 162/1, datë 14.04.2010.

**18.29** Për çështjen që i takon vendimit nr. {\*\*\*}, datë 19.02.2015, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë kundër të pandehurit A. N., subjekti ka dorëzuar në Komision vërtetimin nr. {\*\*\*} prot., datë 11.02.2020, të lëshuar nga kancelari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, sipas të cilit çështja penale është regjistruar në datën 12.03.2014 dhe ka përfunduar në datën 19.02.2015. Kohëzgjatja e gjykimit është 11 muaj e 7 ditë, pra, në tejkallim të afatit 6-mujor të parashikuar për gjykimet penale në Gjykatën e Apelit, për krimet që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim (i pandehuri është gjykuar për veprën penale “Vjedhje e kryer duke shpërdoruar detyrën”, të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal).

**18.30** Lidhur me këtë konstatim, në shpjegimet e datës 10.03.2020, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka sqaruar: *Nga përmbajtja e akteve, ndodhur në dosjen gjyqësore, rezulton se shkaqet e kësaj kohëzgjatjeje kanë të bëjnë me kryerjen e hetimit të pjesshëm në këtë shkallë gjykimi, urdhërimi për kryerjen e një ekspertimi kontabël në kushtet që gjatë hetimeve dhe gjykimit në shkallë të parë mungonte të ishte kryer një veprim i tillë i domosdoshëm dhe i kërkuar si nga i pandehuri dhe nga prokurori. Në këtë çështje, Gjykata e Shkallës së Parë kishte konkluduar me një ndryshim të kualifikimit ligjor të veprimeve të të pandehurit, ndërkohë që prej prokurorisë kërkohej pranimit i akuzës së ngritur prej tij, ndërsa i pandehuri kërkonte deklarimin e tij të pafajshëm. Fillimisht është kërkuar që ekspertimi të kryhej nga një ekspert i licencuar në fushën e auditit të bankave dhe në kushtet që nga Banka {\*\*\*} ka ardhur përgjigje negative, Gjykata e Apelit ka vendosur që këtë detyrë ta kryejë një ekspert kontabël. Kryerja e seancës së betimit dhe kryerja e aktit të ekspertimit ka kërkuar kohë në kushtet që për të kryer këtë akt, lindi domosdoshmëri administrimi i gjithë dokumentacionit për periudhën e pretenduar nga banka përkatëse dhe për shkak të volumit, ky dokumentacion është dorëzuar një seancë më vonë. Gjithashtu, gjatë gjykimit mbi kërkesën e prokurorit, Gjykata e Apelit ka konkluduar se ish-arkëtari i bankës ishte proceduar dhe gjykuar për veprën penale “Dëshmi të rreme” dhe për këtë arsye prokurori ka kërkuar të pyetet edhe ai në këtë proces. Ndërkohë që i pandehuri në ankim ka pretenduar pafajësi, referuar edhe deklarimeve të këtij shtetasi, ish-arkëtarit, gjykata e pranoi këtë kërkesë të prokurorit. Mosparaqitja e arkëtarit në cilësinë e personit nën hetim, për dy seanca është vlerësuar e justifikuar për shkak të paraqitjes prej tij të kërkesës për të qenë i mbrojtur nga një avokat dhe në kushtet e paraqitjes së raportit mjekësor. Tejkallimi i afateve të gjykimit ka ardhur si pasojë e kryerjes së veprimeve hetimore të domosdoshme të pakryera gjatë hetimit dhe gjykimit në shkallë të parë, pa të cilat nuk mund të konkludohej në lidhje me shkaqet ankimore, parashtruar si nga prokuroria, edhe i pandehuri i cili kërkonte pafajësi. Hetimi gjyqësor i kryer është pranuar si nga akuza, edhe nga i pandehuri. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila ka vendosur mospranim rekursi.*

**18.31** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me shkaqet e tejkallimit të afateve në gjykim dhe procesverbalet e seancave gjyqësore të kësaj çështjeje, ku subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, ka qenë kryesuese e trupit gjykues, vlerësoi se janë bindëse, pasi në rastin konkret rezulton që gjykimi tej afatit ligjor të parashikuar, është i justifikuar me kryerjen e hetimit të pjesshëm në këtë shkallë gjykimi, për veprime hetimore të domosdoshme, të

cilat nuk ishin kryer në shkallë të parë, të pranuar si nga akuza, ashtu edhe nga i pandehuri. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila ka vendosur mospranim rekursi.

Më poshtë paraqiten edhe për këtë çështje arsyet përse është shtyrë kaq gjatë procesi gjyqësor në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

**18.32** Më datë 11.04.2014, shtyhet seanca gjyqësore me kërkesë të prokurorit për të paraqitur prova shkresore. Më datë 02.05.2014, shtyhet seanca që të thirret në gjykim Banka {\*\*\*}. Më datë 22.05.2014, seanca gjyqësore është shtyrë për thirrjen e një eksperti nga Banka {\*\*\*}. Më datë 05.06.2014, përsëritet kërkesa për thirrjen e ekspertit nga Banka {\*\*\*}. Më datë 19.06.2014, shtyhet seanca gjyqësore për caktimin e ekspertit kontabël. Më datë 26.06.2014, shtyhet seanca gjyqësore për të përsëritur thirrjen e ekspertit. Më datë 03.07.2014, shtyhet sërish nga pamundësia e ekspertit për t'u paraqitur. Më datë 10.07.2014, eksperti është paraqitur dhe ka bërë betimin. Më datë 24.07.2014, shtyhet seanca për t'i dhënë kohë ekspertit për të përgatitur aktin e ekspertimit. Më datë 11.09.2014, nuk është paraqitur eksperti. Më datë 25.09.2014, shtyhet me kërkesë të prokurorit për të kryer një verifikim në Bankën {\*\*\*}. Më datë 10.10.2014, shtyhet sërish për thirrjen e bankës në gjykim. Më datë 06.11.2014, shtyhet seanca për shkak të dhënies së dorëheqjes nga subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, e cila kishte dhënë vendim për mosfillimin e procedimit penal për shtetasin V. Gj., person nën hetim, çështja e të cilit kishte lidhje me çështjen që gjykonte subjekti i rivlerësimit. Më datë 11.12.2014, shtyhet për t'u njohur eksperti me dokumentacionin. Më datë 12.12.2014, shtyhet seanca që eksperti të përfundojë aktin e ekspertimit. Më datë 08.01.2015, shtyhet gjykimi me kërkesë të shtetasit V. Gj., i thirrur si person nën hetim. Më datë 22.01.2015, ky i fundit kërkon të shtyhet seanca gjyqësore, pasi do mbrohet me avokat që do e zgjedhë vetë. Më datë 30.01.2015, shtetasi V. Gj. kërkon të shtyhet seanca gjyqësore për arsye shëndetësore. Më datë 12.02.2015, shtyhet për të dorëzuar palët konkluzione përfundimtare. Më datë 19.02.2015, shpallet vendimi.

**18.33** Sa më sipër verifikuar, Kolegji vëren se një pjesë e konsiderueshme e seancave të këtij procesi gjyqësor është shtyrë për shkak të thirrjes së ekspertëve nga bankat, fillimisht {\*\*\*}, e më pas Banka {\*\*\*}, e cila pas thirrjes nëpërmjet dy seancave gjyqësore, ka kthyer përgjigje negative, për shkak të së cilës gjykata ka vendosur të thërrasë ekspert kontabël privat. Si rrjedhojë e kësaj situatë, gjykatës i është dashur të shtyjë disa seanca për shkak të kohës së nevojshme për mbledhjen e provave, duke ndikuar kështu në kompleksitetin e çështjes, me pasojë zgjatjen e kohës së gjykimit. Gjithashtu, edhe procesi i heqjes dorë nga gjykimi i çështjes nga ana e trupit gjykues, për të garantuar paanësinë e gjykatës, krijon një çështje tjetër për shqyrtim brenda procesit, e cila merr kohën e saj, duke pasur ndikim direkt në shtyrjen e seancave e më pas në daljen e gjykimit jashtë afateve të arsyeshme.

Lidhur me këto detaje, të sjella si shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore të pasqyruara në procesverbalet e seancave përkatëse, rezultoi se kjo çështje kishte prezent kriterin e kompleksitetit të çështjes, duke përfshirë këtu hetimin e kërkuar si nga prokurori, ashtu edhe nga i pandehuri, korrespondencën e vazhdueshme me bankat, të cilat nuk shprehën gatishmërinë për të



bashkëpunuar me gjykatën, si dhe duke vlerësuar sjelljet e ekspertit dhe mbrojtësit në gjykim, të cilët gjithashtu kanë një ndikim në shtyrjen e afatit të gjykimit duke përfituar nga mjetet ligjore. Në kontekst të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, në rolin e kryesueses së trupit gjykues, ka qenë e kushtëzuar nga kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale, të cilat kanë ndikuar në shtyrjen e afatit të gjykimit të çështjes.

**18.34** Kolegji vëren se në raportin e IKLD-së rezulton se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar 712 çështje gjatë periudhës 3-vjeçare (2014, 2015, 2016) të vlerësimit të aftësive profesionale.

Në vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010, “Për sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve”, në aneksin 1 të tij, janë përcaktuar kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore.

Në pikën 3 të këtij aneksi parashikohet:

*Standardi sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale si më poshtë: [...]*

*h. Gjyqtari i gjykatës së apelit i dhomës penale, si relator, jo më pak se 150 gjykime çështjesh penale.*

*i. Gjyqtari i gjykatës së apelit i dhomës civile, si relator, jo më pak se 200 gjykime çështjesh civile.*

**18.35** Duke iu referuar këtyre standardeve, në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, është e vështirë të bëhet një ndarje e saktë e çështjeve të gjykuara për një seksion të caktuar, për sa kohë ajo është e përfshirë në gjykimet që u përkasin të gjitha seksioneve, pa një specializim në një fushë të caktuar, duke e bërë kështu edhe më të vështirë mundësinë e gjykimit brenda afateve të arsyeshme. Në raportin profesional, në rubrikën “aftësitë organizative” është vlerësuar se aneksi 1 i sistemit të vlerësimit (vendimi i KLD-së) nuk jep standarde minimale për gjyqtarin e gjykatës së apelit që nuk është e organizuar në seksione. Shkronjat “h” dhe “i” të pikës 3 të këtij aneksi, vendosin standardet minimale prej 150 gjykimesh penale për relator në dhomën penale dhe 200 gjykime civile për relator në dhomën civile. Në këto rrethana, nëpërmjet metodës së interpretimit, në raportin profesional është nxjerrë si standard numri prej 200 gjykimesh penale dhe civile për gjyqtarin e gjykatës së apelit, që nuk është i organizuar në seksione. Këto rregulla në rastin e subjektit të rivlerësimit, nënkuptojnë një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 600 gjykime çështjesh për tre vjet. Duke iu referuar të dhënave statistikore të raportit profesional, konstatohet se ngarkesa sasiore e subjektit të rivlerësimit, me 712 çështje, ka qenë mbi standardin minimal të përcaktuar sikur t’i kishte pasur të gjitha çështjet si gjyqtar relator i dhomës civile, të përcaktuar në aneksin 1 më sipër.

**18.36** Në vendimin nr. 21/2019, datë 13.09.2019, Kolegji ka arsyetuar: *Për sa i përket raportit midis zbatimit të standardeve të gjykimit, të miratuara me vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010, të KLD-së, dhe zbatimit të përcaktimeve ligjore përkatëse, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se përparësi ka zbatimi i ligjit organik, në bazë të të cilit ushtron funksionin magjistrati. Subjekt rivlerësimi, në rastin konkret, rezulton të jetë gjyqtari i një gjykate administrative të shkallës së parë, dhe i zbatueshëm për këtë subjekt rivlerësimi është ligji organik nr. 49/2019. Ligji organik nr. 49/2012, në nenin 3, si parim të përgjithshëm, sanksionon gjykimin brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, por pa sanksionuar afat maksimal për gjykimin e çështjeve. Nga ana tjetër, ligji*

*nr. 49/2012, përcakton afate për veprimet përgatitore (neni 25), seancën gjyqësore (neni 27), por nuk përjashton mundësinë e zgjatjes së këtyre afateve, veçanërisht kur ato kanë qenë për shkaqe të përligjura. Trupi gjykues nuk ka konstatuar se zgjatja e afateve ka qenë për faj apo neglizhencë të subjektit të rivlerësimit, por ka ndodhur për shkaqe të përligjura, sikurse pamundësia objektive e subjektit të rivlerësimit, kryesisht për shkak të zënies së të gjithë kohës fizike me procese gjyqësore, që e kanë çuar atë në pamundësi fizike kohore.*

**18.37** Si rrjedhojë të sa më sipër, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit, për shkak të ngarkesës që mbartin gjykatat e apelit, bazuar dhe në faktet e rrethanat e konstatuara gjatë verifikimit të dokumentacionit, duket se ka qenë në pamundësi të kohës fizike për të kryer çështjet brenda afateve të parashikuara në ligj. Një ngarkesë e tejshtuar me çështje ka pamundësuar realizimin e arsytetimeve në afatet e përcaktuara nga legjislacioni procedural civil e penal. Në kuptim të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, ka qenë eficiente dhe efektive në një masë të pranueshme, me cilësi të pranueshme në punë, në respektim të një gjykimi të drejtë dhe të drejtave të palëve në gjykim.

**18.38** Lidhur me çështjen civile nr. {\*\*\*}, ku subjekti i rivlerësimit ka pasur cilësinë e kryesuesit të trupit gjykues, Komisioni ka vendosur: [...] *Transferimin e çështjes civile nr. {\*\*\*} akti, me palë ndërgjyqëse: paditës A. Ç., e paditur Zyra Përmbartimore “{\*\*\*}” ShPK, person i tretë A. (A.) K., të gjykuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.05.2015, pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.* Kolegji vëren se Komisioni ka marrë në shqyrtim denoncimin e shtetasit A. K., i cili ka denoncuar trupin gjykues të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, të përbërë nga Miranda Andoni, I. I. dhe T. Sh., që ka gjykuar çështjen me paditës T. Ç., palë e tretë A. K. dhe i paditur përmbartuesi gjyqësor privat “{\*\*\*}”, me objekt “kundërshtim i veprimeve përmbartimore.

**18.39** Komisioni, lidhur me këtë çështje, ka konkluduar se: *Pavarësisht pretendimeve të subjektit, në kushtet kur zhvillimi i seancës dëgjimore është kryer pa marrë dijeni pala kërkuese (denoncuesi), Komisioni çmoi se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit: “Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga ky kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme”.*

**18.40** Komisioni ka konstatuar se A. K., në denoncimin e paraqitur prej tij, ka pretenduar se trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, që ka gjykuar çështjen ku denoncuesi ishte si person i tretë në gjykim, ka ndryshuar datën për zhvillimin e seancës gjyqësore, nga data 19.05.2015, ora 14:15, për të cilën ishin njoftuar palët, në datën 12.05.2015, në orën 15:17, pa e njoftuar denoncuesin, duke i mohuar të drejtën për të marrë pjesë në seancë gjyqësore, me pasojë mospasjen mundësi nga ana e tij për t’u dëgjuar dhe paraqitur prova lidhur me çështjen.

**18.41** Komisioni, pasi konstatoi pretendimet e denoncuesit, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me sa ka rezultuar, pasi mbetet e paqartë nëse janë zbatuar nga trupi gjykues

dispozitat mbi njoftimet e palëve, parashikuar në K.Pr.Civile. Për këtë arsye, Komisioni i kërkoi subjektit të vërtetojë me dokument shkresor njoftimin e palëve për seancën gjyqësore të datës 12.05.2015, ora 15:17, si dhe të vejë në dispozicion vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe atë të apelit për çështjen ku palë pjesëmarrëse ka qenë denoncuesi A. (A.) K.. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit të datës 10.03.2020, ka sqaruar: “Seanca e parë gjyqësore është planifikuar dhe është zhvilluar në datën 28.04.2015, seancë në të cilën, është paraqitur vetëm personi i tretë, A. K., i cili ka kërkuar shtyrjen e seancës gjyqësore për një ditë tjetër, për shkak se përfaqësuesja e tij, për arsye objektive (rast vdekjeje), nuk mund të ishte e pranishme. Kjo kërkesë është pranuar nga gjykata dhe është vendosur që seanca e radhës të zhvillohej në datën 19.05.2015. Për shkak të një gabimi njerëzor (në kushtet e një dite të ngarkuar gjyqësore), seanca gjyqësore është zhvilluar në datën 12.05.2015, dhe jo në datën 19.05.2015. Personi i tretë nuk kishte dijeni rregullisht për seancën gjyqësore të datës 12.05.2015, pasi njoftimi është marrë nga pala në seancën e mëparshme për datën 19.05.2019. Relatimi nga ana ime, me cilësinë e relatores, se personi i tretë kishte dijeni për seancën e datës 12.05.2015, është kryer referuar faktit që personi i tretë kishte qenë i pranishëm në seancën e mëparshme gjyqësore, por pa u vënë re mospërputhja e datës së seancës që po zhvillohej gjykimi, me datën që kishte marrë dijeni personi i tretë. Në këto rrethana, në aktet në dosje nuk ka njoftim për seancën e datës 12.05.2015. Kjo ka ndodhur në kushtet e një dite të ngarkuar me procese gjyqësore që zhvilloheshin njëra pas tjetrës dhe çështja në fjalë është zhvilluar pas orës 15:00”.

**18.42** Në seancën gjyqësore të zhvilluar në Kolegj më 13.12.2022, lidhur me këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit parashtroi: “[...] Në këtë rast, kemi të bëjmë me një çështje që nuk ka sjellë ndonjë pasojë të rëndë te palët. Është një gabim njerëzor. U gjend përpara meje dosja për shqyrtimin e datës 12, në fakt ishte e datës 19. Ishim në fillimet e sistemit audio, është zhvilluar gjykimi, pala ka qenë në dijeni të procesit, por ndodhi ajo që ndodhi - shqyrtimi gjyqësor u zhvillua pa dijeninë e palës për ditën dhe orën që u zhvillua në fakt. Për ironi të fatit, ankuesi ka qenë i paditur në një proces civil (të them me pak fjalë për çështjen), ka qenë i detyruar të paguante një detyrim monetar për palën paditëse. Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar dhe ka filluar ekzekutimi i vendimit. Në momentin që filloi ekzekutimi i vendimit, personi ka paraqitur ankim për veprimet përmbarimore, ka paraqitur dhe kërkesë për rivendosje në afat. Kërkesa për rivendosje në afat është gjykuar nga trupi gjykues, ku një nga anëtarët kam qenë dhe unë dhe, me shumicë votash, kemi dalë në favor të këtij ankuesi për t’u dhënë e drejta për të ankuar vendimin. Bazuar në vendimin për t’i dhënë të drejtën për ta parashtruar këtë ankim, është vënë çështja në lëvizje, është ankimuar, ka ardhur në Gjykatën e Apelit, ku unë kam qenë relatorja e çështjes. Problematika e zgjidhjes ishte e përcaktuar, ishim të detyruar t’u referoheshim detyrimisht parashikimeve të nenit 469 të Kodit të Procedurës Civile. Ishte përcaktuar që, në rastet kur prishej vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, veprimet përmbarimore nuk pushoheshin, ashtu sikurse ishte vendosur nga përmbaruesi, por duhet të pezulloheshin. Nga pala kreditore, pikërisht ky veprim përmbarimor ishte kundërshtuar dhe kjo ishte çështja që do të gjykonte Gjykata e Apelit. Mendoj se nuk i ka ardhur ndonjë pasojë e rëndë ankuesit nga kjo shkelje për sa i përket zhvillimit të procesit. Pra, sido që të zhvillohej, dhe në datën 12, dhe në datë 19, zgjidhja ishte një, ishte ajo që e kishte përcaktuar Kodi i Procedurës Civile, që përmbaruesi gjyqësor do të vendoste pezullimin e veprimeve përmbarimore dhe jo pushimin e veprimeve përmbarimore, derisa të zgjidhej

përfundimisht çështja në themel. Kjo më shumë për të bërë me dije që çfarë pasoje i ka ardhur këtij ankuesi që u kujtua pas 5 (pesë) vjetëve për t'u ankuar në lidhje me gabimin kaq të rëndë të kryer në ngarkim të tij”.

**18.43** Kolegji vëren se nga dokumentacioni i dosjes, në aktet e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, gjendet i administruar vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, nr. {\*\*\*}, datë 04.02.2015, me palë paditëse T. Ç., palë e tretë A. (A.) K. dhe i paditur përmbaruesi gjyqësor privat “{\*\*\*}”, me objekt: “Kundërshtim i veprimeve përmbarimore”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë vendosi pranimin e kërkesëpadisë së paditësit A. Ç., si dhe kundërshtimin e veprimit përmbarimor: “Vendim pushimi”, datë 15.12.2014, të zyrës përmbarimore “{\*\*\*}” ShPK, duke u urdhëruar kjo zyrë përmbarimore të pezullojë ekzekutimin e titullit ekzekutiv, vendimin nr. {\*\*\*}, datë 11.07.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim personi i tretë, (denoncuesi) A. K., i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.05.2015, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me arsyetimin se, ndryshe nga sa ka pretenduar personi i tretë në ankim, me të drejtë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë i është referuar nenit 469 të K.Pr.Civile, në të cilën është parashikuar se kur priset vendimi i gjykatë së shkallës së parë dhe çështja dërgohet për rigjykim, pezullohet ekzekutimi i vendimit. Më tej, kjo gjykatë arsyeton se në rastin në shqyrtim, është pikërisht në kushtet kur vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, mbi bazën e të cilit është lëshuar urdhri i ekzekutimit, është prishur dhe kjo çështje është kthyer për rigjykim dhe zyra përmbarimore, sipas nenit 469 të K.Pr.Civile, duhet të kishte vendosur pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv dhe jo pushimin e ekzekutimit. Zyra përmbarimore gabimisht i është referuar nenit 616, shkronja “c” e K.Pr.Civile, pasi në rastin në shqyrtim duhet të zbatonte nenin 469 të K.Pr.Civile, i cili rregullon në mënyrë specifike këtë marrëdhënie. Në këtë vendim, është cituar se: “Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtares Miranda Andoni, në mungesë të palëve, pasi bisedoi çështjen në tërësi, vëren [...]. Siç rezulton nga përmbajtja e vendimit, palët në këtë gjykim janë në mungesë”.

**18.44** Subjekti i rivlerësimit paraqiti në Kolegji, bashkëngjitur parashtrimeve, edhe vendimin nr. {\*\*\*} prot., datë 21.09.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “ILD”), me të cilin është vendosur: “1. Arkivimin e rastit të paraqitur nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, nëpërmjet shkresës me nr. {\*\*\*}, datë 28.07.2020. 2. Përcjelljen për trajtim të rastit Komisionit përkatës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor [...]”. Sipas arsyetimit të këtij vendimi, rezulton se shqyrtimi gjyqësor i çështjes civile me nr. {\*\*\*}, të vitit 2015, pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, ka përfunduar më datë 12.05.2015, ndërkohë që vendimi i Komisionit, i cili ka përcjellë për inspektim çështjen e sipërcituar, në funksion të hetimit të shkeljeve të mundshme disiplinore, është paraqitur më datë 29.07.2020, pra tej afatit 5-vjeçar të parashkrimit të përcaktuar në nenin 117 të ligjit nr. 96/2016. Për këtë arsye, bazuar në nenin 120, pika 1, shkronja “b” dhe nenin 121, pika 2, shkronja “a” e ligjit nr. 96/2016, ILD-ja ka vendosur arkivimin e rastit të paraqitur nga Komisioni dhe përcjelljen për trajtim të rastit konkret komisionit përkatës të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**18.45** Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vëren se në çështjen ku denoncuesi ishte person i tretë në gjykim, mangësia e konstatuar është gjykim i çështjes në një datë të ndryshme nga ajo

që i ishte njoftuar denoncuesit në seancën e mëparshme. Kolegji vëren se gjykimi është zhvilluar pa praninë e palëve, gjë e cila evidentohet edhe në vendimin e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, ku citohet mungesa e tyre, si dhe është pranuar nga vetë subjekti i rivlerësimit në Komision dhe në Kolegj. Kolegji vëren se kjo mangësi ka sjellë pasoja për palët në proces, duke i cenuar garantimin e procesit të rregullt ligjor, pasi palëve u mohohet e drejta për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur prova e kundërshtime lidhur me sa pretendojnë. Kolegji vlerësoi se ky proces gjyqësor, pjesë e të cilit ishte denoncuesi A. K., ka pasur një mangësi procedurale, atë të mosnjoftimit të palëve për ndryshimin e datës së seancës gjyqësore. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se asnjëra palë nuk është njoftuar, pasi gjatë seancës gjyqësore në Gjykatën e Apelit Gjirokastër janë evidentuar palët në mungesë, gjë që krijon bindjen e trupit gjykues që kjo problematikë është krijuar për shkak të mungesës së organizimit të gjykimit, por e palidhur në mënyrë të posaçme vetëm me denoncuesin, pasi ka sjellë të njëjtën pasojë edhe për palët e tjera në gjykim. Trupi gjykues, për sa u konstatua më sipër, vlerësoi se në këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në drejtim të aftësive organizative sipas parashikimit të nenit 74, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, por kjo problematikë shfaqet si një rast i veçuar dhe jo një mënyrë pune e subjektit të rivlerësimit, për rrjedhojë, në vlerësimin tërësor të kriterit të aftësive organizative, nuk mund të justifikojë arritjen në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit shfaq mangësi në vlerësimin e këtij kriteri, dhe aq më pak të justifikojë konkluzionin për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në kuptim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

**18.46** Në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik në ankim dhe të mangësive të evidentuara në lidhje me vlerësimin profesional të subjektit, në raportin e IKLD-së dhe në vlerësimin e Komisionit, Kolegji vlerëson se, mbështetur në standardet e përcaktuara në nenin 74 të ligjit nr. 96/2016, subjekti i rivlerësimit për secilin rast të trajtuar, duhet të kishte marrë masa për të shmangur shkeljen e afateve të gjykimit të çështjes, të dorëzimit të dosjeve dhe të dorëzimit të vendimeve të arsyetuara, duhet të verifikonte dosjet gjyqësore me qëllim plotësimin, përfshirjen dhe sistemimin e tyre me aktet e plota dhe të renditura sipas kronologjisë së veprimeve procedurale të ndërmarra gjatë procesit, si dhe duhet të kryente veprimet procedurale brenda afateve ligjore, me qëllim menaxhimin efektiv të procesit gjyqësor.

**18.47** Neni E, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës parashikon se në rast se subjekti i rivlerësimit kryen veprime për të penguar ose vështirësuar vlerësimin e tij, ose rezulton se ka njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime ose një model pune aq të dobët, saqë rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve, ai konsiderohet i papërshtatshëm për të ushtruar funksionin.

Në ligjin nr. 96/2016, lidhur me kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarëve, në nenin 74, “Aftësitë organizative”, parashikohet se aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor. Gjithashtu, në zbatim të nenit 42, pika 1 dhe nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, në rastin në fjalë për kriterin e “aftësive organizative”, duhet të jetë produkt i vlerësimit tërësor të burimeve të përcaktuara me ligj dhe jo i bazuar në një burim të vetëm vlerësimi.

**18.48** Në nenin 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet se procedura e vlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm. Referuar parashikimeve të nenit 78 të ligjit nr. 96/2016, me titull “Nivelet e vlerësimit”, në pikën 3 të tij parashikohet: *Vlerësimi i përgjithshëm “shumë mirë” jepet vetëm në ato raste kur magjistrati vlerësohet “shumë mirë” për tri kritere dhe “mirë” për njërin prej tyre dhe në çdo rast kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit dhe të prokurorisë” duhet të jenë vlerësuar “shumë mirë”.* Sipas këtij parashikimi, një magjistrat duhet të ketë tri kritere të vlerësuar “shumë mirë”, ku këtu të përfshihen patjetër aftësitë profesionale dhe etika e angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit, si dhe një kriter tjetër “mirë”, në mënyrë që të mund të marrë vlerësimin “shumë mirë”. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, në raportin e vlerësimit profesional, rezultojnë probleme vetëm kriteri i aftësisë organizative, por edhe nga problemet e konstatuara të këtij kriteri, nuk ka rezultuar se ka cenuar të drejtat e qytetarëve, pasi në këtë raport është cituar se tejkalimi i afatit të arsyetimit të vendimeve, ka qenë disa ditë me vonesë, por asnjë rast përtej afatit të rekursit.

**18.49** Në përfundim të sa më sipër, shkeljet e konstatuara në vlerësimin e aftësive profesionale do të vlerësohen në raport me seriozitetin e tyre në përfundim të shqyrtimit të këtij kriteri vlerësimi. Për shkaqet e mësipërme, Kolegji vlerëson se këto gjetje do të çmohen nga trupi gjykues të atilla që nuk mund të kenë ndikim në mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore, ndaj pretendimi i Komisionerit se këto shkelje çojnë në vlerësimin me mangësi të kriterit të aftësive organizative të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, nuk gjendet i drejtë dhe i bazuar.

Situata qëndron në harmoni me arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, sipas të cilit është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale, trajtuar edhe në opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias<sup>30</sup>.

**18.50** Në përfundim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, trupit gjykues, ashtu si edhe Komisionit, i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në tri nga katër kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale. Pavarësisht nga ky konstatim, si dhe sa u përshkrua më sipër, rezultoi se sjellja e subjektit të rivlerësimit në disa raste nuk ka qenë në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, lidhur me aftësitë organizative të një gjyqtari. Si rrjedhojë e sa më sipër, Kolegji vlerëson se problematikat e konstatuara nga Komisioni në vendimin objekt kontrolli dhe nga Komisioneri Publik në shkaqet e ankimit, lidhur me dosjet e vlerësuar sipas nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe problematikat e rezultuara nga shqyrtimi në Komision i denoncimit të A. K. nuk ngrihen në nivelin e shkakut që e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm në kuptim të nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 4 e këtij ligji, por me të drejtë Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka arritur nivel minimal në vlerësimin e aftësive profesionale.

- 19.** *Lidhur me kontrollin e figurës*, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, sipas vendimit të Komisionit, ka rezultuar se ka një nivel të besueshëm sipas nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>30</sup> *Shih paragrafin 35 të opinionit CDL-AD (2016)036.*

20. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit, pas hetimit gjyqësor të çështjes, në të cilin u morën në cilësinë e provave të reja shkresore, aktet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura së bashku me apelin kundërshtues edhe në seancë gjyqësore publike, dëgjoi parashtrimet e palëve në debatin gjyqësor dhe konkluzionet përfundimtare, vlerësoi provat e reja së bashku me aktet e fashikullit të Komisionit dhe, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, arriti në konkluzionin se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 257, datë 12.06.2020, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte e ligj dhe, si rrjedhojë, duhet lënë në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 257, datë 12.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.  
U shpall sot, më datë 20.12.2022, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi – kundër*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues, jam kundër vendimit nr. 49 (JR), datë 20.12.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 257, datë 12.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni. Mosdakordësia me shumicën vjen si konsekuencë e qëndrimeve të mbajtura prej meje në vendime të mëparshme të juridiksionit të rivlerësimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe me konstatimin e mangësive profesionale të subjektit të rivlerësimit në çështjen civile me nr. akti 292, të vitit 2015.

### *I. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë*

2. Ndryshe nga shumica e trupit gjykues në Kolegj, konsideroj se shuma që ka shërbyer në shlyerjen e këstit të parë për “Apartament banimi me sip. 123,5 m<sup>2</sup> dhe garazh me sip. 26,9 m<sup>2</sup>”, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë të vitit 2008, si “ndihmë monetare nga nëna ime, E. (T.) S., për pagesën e këstit të parë të apartamentit, 3.780 euro”, në kushtet kur është provuar se nëna e subjektit nuk justifikonte me të ardhura nga burime të ligjshme dhënien e kësaj ndihme në vitin 2008, fakt i konstatuar nga Komisioni, Komisioneri Publik dhe shumica e trupit gjykues, vlerësoj që jo vetëm nuk duhej të llogaritej si e ardhur ashtu siç ka vlerësuar dhe shumica e trupit gjykues, por nuk duhej konsideruar as në zërin “ndryshim i gjendjes së likuiditetit” si shtesë/pakësim. Ky vlerësim mbështet dhe qëndrimin e Komisionerit Publik në ankim, se: [...] *Duke qenë se kjo shumë është depozituar në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit, atëherë bën pjesë në zërin “shtesa/pakësime likuiditete” dhe, si e tillë, vlerësojmë se në këtë zë, e gjithë shuma prej 3.780 eurosh, ose kundërvlera e saj në lekë, nuk duhet të konsiderohet si burim i ligjshëm i pagesës së blerjes së pasurive “apartament dhe garazh” [...]. Me fjalë të tjera, pavarësisht se shuma mund të ekzistojë si gjendje në llogari bankare, mosjustifikimi me të ardhura të ligjshme i krijimit të saj, në mënyrë të pashmangshme e përjashton nga përlllogaritjet në analizën financiare si gjendje likuiditeti ose si e ardhur e ligjshme.*
3. Në këto kushte, diferenca e mungesës së burimeve financiare të ligjshme në shumën 563.009 lekë, për krijimin e pasurisë apartament banimi në Tiranë, si dhe balanca negative e analizës financiare e vitit 2010, do të thellohej e për rrjedhojë bën të pabazuar zbatimin e parimit të proporcionalitetit të parashikuar nga neni 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Mungesa negative e burimeve të ligjshme, në këtë rast, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, do të përfaqësonte një shumë të konsiderueshme për t’u klasifikuar si pamjaftueshmëri në deklarin e pasurisë në kuadër të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

### *II. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*

4. Sa i përket këtij kriteri, mosdakordësia me shumicën e trupit gjykues qëndron në përfundimin e arritur për çështjen civile nr. {\*\*\*}, në të cilën subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, ka pasur cilësinë e kryesuesit të trupit gjykues, për të cilën Komisioni në vendimin objekt shqyrtimi, ka disponuar me transferimin e çështjes pranë organit kompetent për inspektim të *shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.*



5. Për këtë çështje, Komisioni ka arsyetuar se: *Pavarësisht pretendimeve të subjektit, në kushtet kur zhvillimi i seancës dëgjimore është kryer pa marrë dijeni pala kërkuese (denoncuesi), Komisioni çmoi se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit: “Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga ky kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme”.*
6. Sa i përket zhvillimit të seancës gjyqësore më datë 12.05.2015, ndërkohë që palët ishin njoftuar për zhvillimin e saj më datë 19.05.2015, ashtu siç arsyetohet shumica e trupit gjykues, *kjo mangësi ka sjellë pasoja për palët në proces, duke i cenuar garantimin e procesit të rregullt ligjor, pasi palëve u mohohet e drejta për t’u dëgjuar dhe për të paraqitur prova e kundërshtime lidhur me sa pretendojnë. Kolegji vlerësoi se ky proces gjyqësor, [...] ka pasur një mangësi procedurale, atë të mosnjoftimit të palëve për ndryshimin e datës së seancës gjyqësore. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezultoi se asnjëra palë nuk është njoftuar, pasi gjatë seancës gjyqësore në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër janë evidentuar palët në mungesë, gjë që krijon bindjen e trupit gjykues që kjo problematikë është krijuar për shkak të mungesës së organizimit të gjykimit, por e palidhur në mënyrë të posaçme vetëm me denoncuesin, pasi ka sjellë të njëjtën pasojë edhe për palët e tjera në gjykim. Trupi gjykues, për sa u konstatua më sipër, vlerësoi se në këtë çështje subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në drejtim të aftësive organizative, sipas parashikimit të nenit 74, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, por kjo problematikë shfaqet si një rast i veçantë dhe jo një mënyrë pune e subjektit të rivlerësimit, për rrjedhojë, në vlerësimin tërësor të kriterit të aftësive organizative, nuk mund të justifikojë arritjen në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit shfaq mangësi në vlerësimin e këtij kriteri, dhe aq më pak të justifikojë konkluzionin për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.*
7. Në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, nuk ka treguar kujdesin e duhur për garantimin e një procesi të rregullt gjyqësor, në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues, pasi ajo nuk mund të zhvillonte seancën në mungesë të palëve, pa u siguruar paraprakisht që së paku, nëse palët të cilat kishin munguar në seancën gjyqësore pararendëse të datës 28.04.2015 [paditësi A. Ç. dhe i padituri Zyra Përmbartimore “{\*\*\*}” ShPK], ishin njoftuar rregullisht për seancën duke verifikuar letërthirrjet dhe marrjen e njoftimit.
8. Në cilësinë e gjyqtare në pakicë, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale, në zbatimin e neneve 129 dhe 130 të Kodit të Procedurës Civile, të cilat në asnjë rast nuk mund të justifikohen me ngarkesën në punë të subjektit apo me pasojat të cilat mund t’u vijnë palëve, pasi zbatimi i dispozitave procedurale qëndron i pavarur nga vendimmarrja më pas për çështjen. Këto mangësi të cilat afektojnë kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit, duhet të ishin vlerësuar ndryshe nga shumica e trupit gjykues.
9. Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit 7 (shtatë) ditë përpara seancës së caktuar, për mua si gjyqtare në pakicë, përveçse sa arsyetuar më sipër për cenim të procesit të rregullt ligjor, tregon një tendencë të subjektit për të zhvilluar gjykimin në mungesë të palëve, minimalisht gjyqtarja duhet të kishte bërë verifikimin e paraqitjes së palëve, mënyrën e njoftimit të tyre dhe pastaj vazhdimin e gjykimit.
10. Për sa më sipër, mungesa e burimeve financiare të ligjshme në vlerësimin e kriterit të pasurisë, së bashku me mangësinë profesionale të konstatuar në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, si një rast flagrant në praktikën gjyqësore, bëjnë që vlerësimi im për këtë çështje të mbështesë

kërkesën e Komisionerit Publik me parashtrimet përfundimtare në seancën gjyqësore të datës 19.12.2022, për ndryshimin e vendimit nr. 257, datë 12.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni.

**GJYQTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*